



# Rritja e bashkëpunimit midis organeve të zbatimit të ligjit dhe palëve të tjera të interesuara në P/KEDh

Autore: **Fatos Makolli**, Eksperte e jashtme e RNR-së

Radicalisation Awareness Network

**RAN**   
Practitioners

# **Rritja e bashkëpunimit midis organeve të zbatimit të ligjit dhe palëve të tjera të interesuara në P/KEDh**

## NJOFTIM LIGJOR

Ky dokument është përgatitur për Komisionin Evropian, por i njëjti pasqyron pikëpamjet vetëm të autorit, dhe Komisioni Evropian nuk mban përgjegjësi për çfarëdo pasoje të mundshme që mund të gjenerohet nga ripërdorimi i këtij botimi. Më shumë informacion mbi Bashkimin Evropian mund të gjeni në faqen e internetit (<http://www.europa.eu>)

Luksemburg: Zyra e publikimeve e Bashkimit Evropian, 2023

© Bashkimi Evropian, 2023



Politika e ripërdorimit të dokumenteve të Komisionit Evropian zbatohet me Vendimin e Komisionit 2011/833/BE të 12 dhjetorit 2011 për ripërdorimin e dokumenteve të Komisionit (Gazeta Zyrtare L 330, 14.12.2011, f. 39). Nëse nuk parashihet ndryshe, ripërdorimi i këtij dokumenti është autorizuar sipas licencës Creative Commons Attribution 4.0 International (CC-BY 4.0) <https://creativecommons.org/licenses/by/4.0/>. Kjo do të thotë se përdorimi ose ripërdorimi lejohet me kusht që të përmendet autori dhe të tregohen ndryshmet e mundshme.

Për çdo përdorim ose riprodhim të elementeve që nuk janë në pronësi të Bashkimit Evropian, leja mund të kërkohet drejtpërdrejt nga titullarët përkatës të drejtave.

## Hyrje

Ekstremizmi i dhunshëm është si çështje sigurie ashtu edhe problem social. Prandaj, qasjet për të trajtuar ekstremizmin e dhunshëm duhet të krijohen në atë mënyrë që do të promovojnë përfshirjen e elementeve të ndryshme shoqërore dhe niveleve qeveritare.<sup>1</sup> Trajtimi i ndikimit të çdo forme ekstremizmi kërkon gjithëpërfshirje dhe multidisiplinartet me përfshirjen e shumë palëve të interesuara, jo vetëm ato të organeve të zbatimit të ligjit dhe të sigurisë, por edhe nga shoqëria civile dhe komuniteti. Vendet e Ballkanit Perëndimor (BP), veçanërisht në dekadën e fundit, janë përballur dhe vazhdojnë të përballen me kërcënimet e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit, qoftë ky ekstremizëm etno-nacionalist apo i motivuar fetarisht me tendencë për rritje të ekstremizmit të djathtë. Raportet dhe hulumtimet e brendshme qeveritare dhe të organizatave të shoqërisë civile (OSHC), raportet ndërkombëtare për BP, si p.sh. raportet e progresit të Komisionit Evropian për vendet e BP-së, si dhe raportet e vendeve të Departamentit të Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA) mbi terrorizmin, e njohin progresin dhe sukseset e arritura në fushën e parandalimit dhe luftimit të ekstremizmit të dhunshëm (P/KEDh) siç është hartimi i legjislacionit, krijimi i mekanizmave apo sukseset e organeve të zbatimit të ligjit.<sup>2</sup> Megjithatë, është bërë përparim i kufizuar në krijimin e një qasjeje të qëndrueshme me shumë agjenci për P/KEDh.<sup>3</sup> Ndërsa vendet e BP-së kanë filluar të krijojnë një histori të adresimit të P/KEDh me mekanizma ndërinstitucionalë, duke përfshirë agjencitë e zbatimit të ligjit, segmente të shoqërisë civile dhe aktorë ndërkombëtarë, intervistat e kryera për këtë dokument tregojnë se kjo qasje është ende relativisht e re, pasi perceptimet e përgjithshme të politikëbërësve dhe të komunitetit të P/KEDh ishin se ekstremizmi i dhunshëm është ende kryesisht një çështje e organeve të zbatimit të ligjit dhe të sigurisë.

Ndryshimi në qasje është veçanërisht i dukshëm si përgjigje ndaj trajtimit të fenomenit të luftëtarëve të huaj terroristë (LHT) që udhëtuan në Siri dhe Irak. Në vitin 2014, me mbështetjen e BE-së dhe të SHBA-ve, të gjitha vendet e BP-së miratuan një qasje më holistike duke përfshirë P/KEDh-në dhe duke inkuadruar aktorë të tjerë relevantë, si shoqërinë civile, OJQ-të dhe komunitetet fetare. Për shkak të fokusit ndërkombëtar në P/KEDh dhe mbështetjes kushtuar kësaj fushe, vendet e BP-së kanë krijuar mekanizma dhe politika të dedikuara. Megjithatë, është e paqartë nëse këto mekanizma mund të bëhen plotësisht funksionale dhe të qëndrueshme në afat të gjatë për arsytet e mëposhtme:

- ngritja e sfidave të reja që kanë të bëjnë me LHT-të e kthyer dhe familjet e tyre duke devijuar përpjekjet nga parandalimi parësor dhe dytësor për t'u fokusuar më shumë në rehabilitimin dhe riintegrimin (RdheR),
- mungesa e koordinimit ndërmjet qeverisë qendrore dhe palëve të interesuara lokale,
- mungesa e financimit, shpërndarjes së burimeve dhe varësia nga fondet e donatorëve.

OSHC-të luajnë një rol vendimtar në qasjen e përfshirjes së gjithë shoqërisë ndaj P/KEDh. Aktorët e OSHC-ve janë shpesh të pozicionuar mirë, të besueshëm dhe me përvojë në punën me grupe specifike për të ndihmuar në identifikimin dhe adresimin e ankesave që i bëjnë individët më të prekshëm ndaj ndikimit të grupeve të dhunshme ekstremiste.<sup>4</sup>

Në vendet e Ballkanit Perëndimor, përfshirja e shtuar e OSHC-ve në P/KEDh filloi gjatë viteve 2014-2015, fillimisht në ndërgjegjësimin për rreziqet nga ekstremizmi i dhunshëm dhe terrorizmi dhe gradualisht duke u

---

<sup>1</sup> 'Understanding Referral Mechanisms in Preventing and Countering Violent Extremism and Radicalization That Lead to Terrorism: Udhëzues për Evropën Juglindore', 39, aksesuar më 15 gusht 2022, <https://www.osce.org/secretariat/418274>

<sup>2</sup> 'Balkans-Regional-Report.Pdf', 27, aksesuar më 31 tetor 2022, <https://h2020connekt.eu/wp-content/uploads/2021/04/Balkans-Regional-Report.pdf>

<sup>3</sup> Mensur Hoti, Pyetësor për palët e interesuara të qeverisë, 30 korrik 2022.

<sup>4</sup> 'Roli i shoqërisë civile në parandalimin dhe luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm: Udhëzues për Evropën Juglindore', 10, aksesuar më 7 mars 2023, <https://www.osce.org/secretariat/400241>

\*Ky kategorizim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve mbi statusin, dhe është në përputhje me RKSKB 1244 dhe Mendimin e GJND-së për shpalljen e pavarësis së Kosovës.

përfshirë në hartimin e dokumenteve të politikave dhe strategjive, e më pas duke u angazhuar drejtpërdrejt në P/KEDh dhe RdheR.

Përfshirja dhe roli i OSHC-ve ndryshojnë nga vendi në vend. Në Kosovë\* ka një përfshirje më të madhe të OShC-ve në të gjitha qasjet dhe aktivitetet e P/KEDh-së, duke përfshirë në politikëbërjen, hartimin dhe zbatimin e dokumenteve strategjike. Në vendet e tjera të BP-së, ka përfshirje të OShC-ve në parandalimin, rehabilitimin dhe riintegrimin; megjithatë, ka mungesë të të dhënave konkrete për përfshirjen e tyre në strategji dhe politikëbërje.

Ekziston nevoja për angazhim më të madh të OSHC-ve në të gjitha proceset e P/KEDh, duke filluar nga hartimi i strategjive dhe politikave, parandalimi, ndërhyrja, rehabilitimi dhe riintegrimi. Për të arritur qasjen e përfshirjes së gjithë shoqërisë, qeveritë në vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të krijojnë një mjedis më të favorshëm për përfshirjen e OSHC-ve duke i përfshirë ato në të gjitha proceset, në ndërtimin e besimit dhe të partneriteteve dhe në ndërtimin e kapaciteteve.

Ky punim synon të trajtojë sfidat dhe pengesat që paraqiten gjatë punës multidisiplinare në adresimin e P/KEDh-së. Ai do të identifikojë mësimet nga e kaluara dhe praktikat e mira që mund të hulumtohen më tej, të avancohen dhe të përshtaten me kontekstin aktual të BP-së. Për më tepër, do të identifikohen fushat në të cilat duhet të forcohet bashkëpunimi ndërmjet aktorëve të zbatimit të ligjit/sigurisë dhe aktorëve të tjerë përkatës, si në parandalimin dytësor ashtu edhe atë terciar. Punimi do të demonstrojë modelet e bashkëpunimit të sektorit të zbatimit të ligjit/sigurisë me aktorë të tjerë përkatës në vendet e BE-së dhe se si ato modele mund të përshtaten duke marrë parasysh legjislacionin në fuqi në vendet e BP-së.

Në pjesën e fundit do të jepen rekomandime se si mund të forcohet bashkëpunimi ndërmjet aktorëve midis ekipeve multidisiplinare me theks të veçantë në marrëdhëniet ndërmjet zyrtarëve të zbatimit të ligjit/sigurisë dhe aktorëve të tjerë përkatës në P/KEDh. Metodologjia e përdorur përfshin burime parësore duke përdorur pyetësorë dhe dokumente zyrtare si dhe kërkime të literaturës ekzistuese në fushën e P/KEDh-së, veçanërisht dokumentet e RVR-së dhe një krahasim të modeleve ekzistuese të shteteve në qasjen gjithëpërfshirëse për adresimin e P/KEDH-së.

## Përmbledhje e sfidave, nevojave dhe mësimëve të nxjerra nga bashkëpunimi ndërmjet aktorëve të sigurisë dhe aktorëve të tjerë të P/KEDh

Të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor përballen me një formë të ekstremizmit të dhunshëm, qoftë ekstremizmi i (dhunshëm i) krahut të djathtë, ekstremizmi i majtë apo ekstremizmi islamik, i cili i sfidon institucionet dhe kohezionin social në përgjithësi në vendet e BP-së.<sup>5</sup> Megjithatë, përvoja në adresimin e ideologjive të ndryshme të pranishme në rajon ndryshon dhe është e lidhur kryesisht me LHT-të, pasi vendet e BP-së kanë zhvilluar një mori programesh dhe politikash për P/KEDh në fushën e RdheR të LHT-ve dhe të familjeve të tyre.<sup>6</sup> Megjithatë, pavarësisht progresit të njohur nga raportet e institucioneve ndërkombëtare, duket se përpjekjet e vendeve të BP-së janë të kufizuara dhe ende nuk ka qëndrueshmëri të mekanizmave të qasjes multidisiplinare në P/KEDh.<sup>7</sup>

Koordinimi ndërmjet pushtetit qendror dhe atij lokal mbetet sfidues, për shkak të mungesës së kapaciteteve lokale në P/KEDh. Gjithashtu, përfshirja e segmenteve të shoqërisë civile dhe krijimi i pronësisë së

---

<sup>5</sup> '2021 Enlargement Package', Tekst, Komisioni Evropian - Komisioni Evropian, aksesuar më 31 tetor 2022, [https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip\\_21\\_5275](https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip_21_5275)

<sup>6</sup> '2021 Enlargement Package'.

<sup>7</sup> '2021 Enlargement Package'.

procese nga shoqëria civile është një sfidë për shkak të mungesës së burimeve lokale. Shumica e granteve ndërkombëtare janë të fokusuar/dedikuara për të mbështetur përpjekjet e RdheR, në vend të parandalimit parësor dhe dytësor të ekstremizmit të dhunshëm. Për më tepër, kur punojnë brenda domenit të P/KEDh, OSHC-të hasin në rezistencë në lidhje me shkëmbimin e informacionit nga sektori i sigurisë, që perceptohet si lojtari dominues në P/KEDh.<sup>8</sup> Ky mosangazhim ndërsektorial është rezultat kryesisht i mungesës së mekanizmave formalë rregullatorë dhe të politikave që mbështesin dhe rregullojnë shkëmbimin e informacionit. Për më tepër, ndryshimi në kulturat dhe objektivat organizative midis palëve të interesuara është një sfidë për të formuar një qasje efektive multidisiplinare.<sup>9</sup>

Megjithatë, disa vende të BP-së kanë arritur të koordinojnë veprimet dhe të krijojnë organe ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit/sigurisë dhe palëve të tjera të interesuara që kanë një rol në P/KEDh.<sup>10</sup> Në seksionin e mëposhtëm, përshkruhen shkurt mekanizmat ekzistues në vendet e përzgjedhura të Ballkanit Perëndimor dhe paraqiten dokumentet strategjike ose programet për P/KEDh, si dhe nevojat dhe mësimet e nxjerra.

## a) Struktura institucionale dhe kuadri ligjor i vendeve të Ballkanit Perëndimor

Të gjitha vendet në BP kanë miratuar legjislacion të përgjithshëm në fushën e parandalimit dhe luftimit të terrorizmit dhe përgjithësisht konsiderohen se janë në harmoni të plotë ose të ngushtë me legjislacionin e BE-së, duke përfshirë përkufizimin dhe sanksionimin e të gjitha formave të terrorizmit.

Pothuajse të gjitha vendet e BP-së janë marrë me çështjen e parandalimit dhe luftimit të terrorizmit përmes strategjive kombëtare kundër terrorizmit. Megjithatë, përfshirja e qytetarëve të vendeve të Ballkanit Perëndimor në zonën e konfliktit, kryesisht brenda organizatave terroriste, si dhe përhapja e narrativave dhe ideologjive ekstremiste, identifikuan nevojën për të forcuar përpjekjet e P/KEDh-së, duke adresuar shqetësimet dhe kërcënimet e identifikuar përmes dokumenteve strategjike dhe planifikimit të ligjeve kombëtare.

Përpjekjet e para për të hartuar dokumente strategjike për P/KEDh në shumicën e vendeve të BP-së datojnë kryesisht nga viti 2015. Megjithatë, në vitet e fundit, duke reflektuar mbi tendencat, sfidat dhe kërcënimet e reja në zhvillim, ka pasur një kuptim të përbashkët të përfshirjes së P/KEDh-së në kuadrin e Strategjive Kombëtare Kundër Terrorizmit, si p.sh. në rastin e Shqipërisë, Bosnjë dhe Hercegovinës, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut. Megjithatë, për arsye të ndryshme, disa nga vendet e Ballkanit Perëndimor po përballen me sfida në realizimin e objektivave të tyre, me përjashtim të Shqipërisë, e cila tashmë ka miratuar Strategjinë Ndërsektoriale kundër Terrorizmit 2021-2025 dhe Planin e saj të Veprimit 2021-2023, bazuar në katër shtyllat kryesore, parandalimin, mbrojtjen, ndjekjen dhe reagimin ndaj terrorizmit, bazuar në Strategjinë e BE-së kundër terrorizmit. Strategjia e re e Bosnjë-Hercegovinës kundër terrorizmit (KT)/P/KEDh (2021-2026) u miratua në tetor të vitit 2022. Aktualisht, planet e veprimit janë duke u prodhuar nga autoritetet në nivel federal-shtetëror (Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës, Republika Serbe dhe Distrikti i Bërçkos). Megjithatë, Komisioni Evropian rekomandon që strategjia e re të miratohet në përputhje me politikën e BE-së dhe t'i kushtohet rëndësi e veçantë P/KEDh-së, duke i mbuluar të gjitha format e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm (politik, etno-nacionalist dhe fetar) dhe adresimin e tyre edhe në aktivitetet në terren për P/KEDh.<sup>11</sup> Bazuar në intervistat e kryera me ekspertë lokalë, këto rekomandime janë marrë parasysht, dhe për më tepër, roli i OSHC-ve do të detajohet më tej në dokumentet vijuese (planet e veprimit).<sup>12</sup> Kosova, gjatë vitit 2022, pas vlerësimit të masave të marra deri më tani, si dhe bazuar në vlerësimin e situatës

<sup>8</sup> Eric Rosand dhe Eric Manton, 'Lessons Learned from Preventing and Countering Violent Extremism in the Western Balkans' 41 (2021): 3, [https://www.gcerf.org/wp-content/uploads/2021/05/rosand\\_and\\_manton\\_newsbrief.pdf](https://www.gcerf.org/wp-content/uploads/2021/05/rosand_and_manton_newsbrief.pdf)

<sup>9</sup> Luan Keka, Pyetësor për palët e interesuara të qeverisë, 21 qershor 2022.

<sup>10</sup> Keka.

<sup>11</sup> Drejtoria e Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit, 'Raporti për Bosnje dhe Hercegovinën për vitin 2021', 38–39, aksesuar më 10 gusht 2022, [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/bosnia-and-herzegovina-report-2021\\_en](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/bosnia-and-herzegovina-report-2021_en)

<sup>12</sup> Dr. Vllado Azinoviç, Pyetësor për palët e interesuara nga radhët e ekspertëve, 1 gusht 2022.

dhe të kërcënimeve të reja të shfaqura nga ekstremizmi i dhunshëm dhe terrorizmi, ka hartuar një strategji të re kundër terrorizmit 2023-2028, e cila është publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB)<sup>13</sup> në korrik të vitit 2023.<sup>14</sup>

Serbia ende nuk ka hartuar një strategji të re kombëtare për të zëvendësuar Strategjinë kombëtare për parandalimin dhe luftimin e terrorizmit (2017-2021). Megjithatë, mekanizmi i rregullt për monitorimin dhe raportimin në lidhje me zbatimin e strategjisë nuk ishte funksional bazuar në raportin e Komisionit Evropian për Serbinë për vitin 2022.<sup>15</sup>

Maqedonia e Veriut, si edhe vendet e tjera të BP-së, ka miratuar strategji kombëtare për luftimin e terrorizmit (2018-2022) dhe për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm (2018-2022) me plane veprimi përkatëse.

Mali i Zi miratoi Strategjinë e tij të parë Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm për vitet 2016-2018 dhe hartoi Strategjinë e re Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm 2020-2024 në tetor të vitit 2022.

Të gjitha dokumentet strategjike dhe draft dokumentet e vendeve të BP-së në proces miratimi për P/KEDh përbëjnë bazën për adresimin e sfidave dhe kërcënimeve përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse, bazuar në rolin e rëndësishëm që kanë të gjitha institucionet në nivel qendror, por edhe në nivelin lokal, duke theksuar rolin e pazëvendësueshëm të shoqërisë civile dhe bashkëpunimin me të.

## b) Mekanizmat ekzistues për LT dhe P/KEDh në vendet e Ballkanit Perëndimor

Pothuajse të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor kanë ngritur dhe operacionalizuar mekanizma koordinimi në fushën e LT dhe P/KEDh, të cilat i përfshijnë agjencitë dhe institucionet e sigurisë dhe të zbatimit të ligjit në nivel qendror dhe lokal, si p.sh. institucionet arsimore, shërbimet sociale, shërbimet shëndetësore, shoqërinë civile, OSHC-të dhe sektorin privat.

Në vendet e BP-së, aktori kryesor në LT është kryesisht organi i zbatimit të ligjit (policia), i mbështetur nga aktorë të tjerë të sigurisë, duke përfshirë agjencitë shtetërore të inteligjencës. Roli i organeve të zbatimit të ligjit në mekanizmat e P/KEDh është fokusuar kryesisht në qasjet e policimit në komunitet.

Të gjitha modelet e vendeve të Ballkanit Perëndimor përcaktojnë një qasje gjithëpërfshirëse ndaj kërcënimeve nga terrorizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm. Për më tepër, shumica e vendeve të BP-së kanë përqafuar një qasje të përfshirjes së gjithë shoqërisë ndaj P/KEDh.

### Qasja e përfshirjes së gjithë shoqërisë

Një qasje ndaj P/KEDh që parashikon një rol për aktorët e shoqërisë civile dhe aktorët joqeveritarë, si dhe për aktorët përkatës qeveritarë nëpër sektorë të ndryshëm, në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm (OSBE).<sup>16</sup>

Vendet e BP-së kanë krijuar mekanizma specifike koordinues për çështjet që lidhen me P/KEDh, të cilat ndryshojnë për nga pozicioni dhe hierarkia e tyre nga një vend në tjetrin, por janë mjaft të ngjashëm për sa i përket misioneve dhe angazhimeve të tyre. Përderisa në Shqipëri dhe në Maqedoninë e Veriut janë krijuar

---

<sup>13</sup> 'Dokumentet Strategjike të MIAPA', aksesuar më 1 gusht 2023, <https://mpb.rks-gov.net/f/39/Strategic-documents>

<sup>14</sup> Rebeka Qena, Pyetësor për palët e interesuara nga OSHC-të, 28 korrik 2022.

<sup>15</sup> 'Raporti për Serbinë për vitin 2022', aksesuar më 31 korrik 2023, [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/serbia-report-2022\\_en](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/serbia-report-2022_en)

<sup>16</sup> 'Qasja e përfshirjes së gjithë shoqërisë për parandalimin dhe luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm', 7, aksesuar më 3 shkurt 2023, [https://www.osce.org/files/f/documents/a/7/444340\\_0.pdf](https://www.osce.org/files/f/documents/a/7/444340_0.pdf)

subjekte të veçanta, në Kosovë dhe në Serbi këto mekanizma janë të vendosur në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ndërsa në Bosnje dhe Hercegovinë ky mekanizëm ndodhet në kuadër të Ministrisë së Sigurisë.

## Shqipëria

Shqipëria ka krijuar Qendrën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (Qendra CVE), e cila është përgjegjëse për ngritjen e kapaciteteve, koordinimin e aktiviteteve të KEDh nëpër institucionet qeveritare dhe mbikëqyrjen e zbatimit të strategjisë kombëtare të KEDh.<sup>17</sup> Qendra e Koordinimit CVE në Shqipëri është gjithashtu e angazhuar me institucionet në nivel të qeverisjes lokale për të rritur ndërgjegjësimin për P/KEDh dhe për vlerësimin e punës nga palët e interesuara në bashkitë përkatëse në ngritjen e Këshillave Vendorë të Sigurisë (KVS). Këto KVS përbëhen nga praktikues të vijës së parë, si mësues, psikologë, sociologë dhe oficerë të policisë në komunitet, dhe komunitete fetare. Shtrirja e Qendrës së Koordinimit CVE përfshin staf në burgje dhe në shërbimet e provës.<sup>18</sup> Vlen të përmendet se bashkëpunimi midis agjencive të zbatimit të ligjit/sigurisë dhe palëve të tjera të interesit po ndodh kryesisht rreth RdheR me LHT-të dhe familjet e tyre që janë kthyer nga Siria.<sup>19</sup>

## Bosnja dhe Hercegovina

Ministria e Sigurisë së Bosnjës dhe Hercegovinës është institucioni kryesor përgjegjës qeveritar që merret me P/KEDh në nivel kombëtar dhe ka një zyrë të dedikuar për bashkëpunim me aktorë të tjerë në këtë fushë. Ashtu si në vendet e tjera të BP-së, organizata të ndryshme ndërkombëtare mbështesin dhe zbatojnë programe të ndryshme në fushën e P/KEDh-së, si ngritja e kapaciteteve, ndërgjegjësimi, deradikalizimi, riatdhesimi dhe rehabilitimi.

Për sa i përket palëve të interesuara të përfshira, një gamë e gjerë institucionesh është aktive në luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm dhe në trajtimin e LHT-ve të kthyer dhe familjeve të tyre.

Projekti 'Forcimi Institucional: Krijimi i një Mekanizmi Formal Referimi për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm në Bosnje dhe Hercegovinë'<sup>20</sup> i Organizatës Ndërkombëtare për Migrim (IOM) parashikon punën me familjet, median, qendrat e punësimit, kryetarët lokalë të bashkive/komunave, policinë, Bashkësinë islame dhe rininë. Qëllimi është të krijohet një qasje që përdor mekanizmin e referimit për të identifikuar individët në rrezik dhe për t'u përgjigjur herët dhe në mënyrë të përshtatshme.<sup>21</sup> Ekziston gjithashtu një bashkëpunim midis OSHC-ve ndërkombëtare dhe vendore në zbatimin e projekteve të ndryshme për P/KEDh dhe koordinimin e përpjekjeve ndërmjet palëve të interesuara.

## Kosova

Qeveria e Kosovës ka emëruar Ministrin e Punëve të Brendshme si Koordinator Kombëtar për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit, i cili i mbikëqyr dhe i koordinon përpjekjet ndërinstucionale në P/KEDh.<sup>22</sup>

Gjithashtu, shumë aktorë të tjerë janë të përfshirë dhe kanë koordinuar aktivitete në këtë drejtim. Vlen të theksohet se palë të tjera të interesuara janë shoqëria civile, ekspertët vendorë dhe ndërkombëtarë, organizatat qeveritare dhe joqeveritare (OJQ) dhe Bashkësia Islame e Kosovës (BIK). OSHC-të në Kosovë padyshim përfaqësojnë një nga palët më të rëndësishme të interesit në ngritjen e vetëdijes, deradikalizimin

---

<sup>17</sup> Drejtoria e Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit, 'Raporti për Shqipërinë për vitin 2021', 43,44, aksesuar më 12 gusht 2022, [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2021\\_en](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2021_en)

<sup>18</sup> Drejtoria e Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit, 43,44.

<sup>19</sup> Drejtoria e Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit, 43,44.

<sup>20</sup> Damir Kapixhi, 'BOSNJA DHE HERZEGOVINA', 9, aksesuar më 12 gusht 2022, [https://h2020connekt.eu/wp-content/uploads/2021/01/Bosnia\\_CONNEKT\\_Approaches\\_to\\_extremism.pdf](https://h2020connekt.eu/wp-content/uploads/2021/01/Bosnia_CONNEKT_Approaches_to_extremism.pdf).

<sup>21</sup> Kapixhi, 9.

<sup>22</sup> Drejtoria e Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit, 'Raport për Kosovën për vitin 2021', 19 November 2021, 44, [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/kosovo-report-2021\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/kosovo-report-2021_en).



dhe P/KEDh-në. Bashkësia ndërkombëtare ka kryesisht një rol për ngritjen e kapaciteteve dhe këshillues, dhe duhet nënvizuar se shumica e financimit për OSHC-të lokale në parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm vjen prej tyre.<sup>23</sup>

Me strategjitë ekzistuese, është përfshirë qasja e përfshirjes së gjithë shoqërisë ndaj P/KEDh-së dhe më shumë përgjegjësi u është dhënë aktorëve lokalë. Në këtë kontekst, niveli lokal përbëhet nga Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi (KKSb), të udhëhequra nga kryetarët e komunave me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të këshillit komunal, institucioneve të sigurisë, përfaqësuesve etnikë dhe fetarë, OSHC-ve, mediave lokale dhe bizneseve. Për më tepër, në vitin 2016, u krijua mekanizmi i parë i referimit për P/KEDh si projekt pilot në një komunë, i cili u tregua i suksesshëm dhe pritet të zbatohet edhe në tre komuna të tjera.<sup>24</sup>

Ndryshe nga vendet e tjera, bashkëpunimi dhe koordinimi i aktiviteteve në mes të organeve të zbatimit të ligjit/sigurisë dhe palëve të tjera të interesuara në P/KEDh në Kosovë kryesisht zhvillohet përmes Divizionit për Parandalimin dhe Riintegrimin e Personave të Radikalizuar (DPRPR). Ky mekanizëm është krijuar në vitin 2017 në MPB dhe është i ngarkuar kryesisht me koordinimin ndërsektorial të aktiviteteve riintegruese në nivel vendi për të burgosurit e liruar (të akuzuar për terrorizëm). Zyrtarët pjesëmarrës janë nga MPB-ja, Policia e Kosovës (PK), Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Shërbimi Sprovues i Kosovës (SHPK), Shërbimi Korrektues i Kosovës (SHKK), komunat dhe palët e tjera të interesuara.<sup>25</sup> Ky bashkëpunim në vitet e fundit ka ndodhur në riatdhesimin e LHT-ve dhe të familjeve të tyre, si dhe në procesin e riintegrimin, rehabilitimit dhe risocializimit. Sfidë mbetet mungesa e vlerësimeve të strukturuar të rrezikut nga disa aktorë të rëndësishëm, duke përfshirë SHKK-në, SHPK-në dhe MPB-në, që nevojiten për t'iu përgjigjur nevojave dhe rreziqeve të paraqitura nga të kthyerit dhe qytetarët e riatdhesuar.<sup>26</sup> Përkundër këtyre aktorëve, PK-ja dhe intelijenca vunë re se ata kanë përdorur modelet ekzistuese, si VERA2 dhe ERG22, për të vlerësuar nivelin e kërcënimit nga LHT-të.<sup>27</sup>

## Maqedonia e Veriut

Maqedonia e Veriut ka një Komitet Kombëtar për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftimin e Terrorizmit (KKPEDhLT), kryetari i të cilit është Koordinatori Kombëtar për LT dhe KEDh. Në Komitet janë të përfaqësuar institucionet kyçe përgjegjëse për LT dhe ekstremizmin e dhunshëm si p.sh. përfaqësues nga të gjitha ministrinë, policia dhe komuniteti i inteligjencës.<sup>28</sup> Ky organ është përgjegjës për koordinimin e bashkëpunimit ndërinstucional në nivel kombëtar dhe lokal. Në praktikë, KKPEDhLT-ja kreu aktivitete ndërgjegjësuere rreth planit kombëtar të veprimit për KEDh për të forcuar kapacitetin zbatues.<sup>29</sup>

## Serbia

Institucioni kryesor përgjegjës për zbatimin e strategjisë për parandalimin dhe luftimin e terrorizmit në Serbi është Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa palët e tjera relevante janë shërbimi i inteligjencës, ministrinë relevante, palët e interesuara nga sektori privat dhe shoqëria civile.<sup>30</sup> Në Strategjinë kundër Terrorizmit 2017-2021, Serbia nënvizon përfshirjen e OSHC-ve si bashkëpunëtorë dhe ndonjëherë si partnerë në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm. Megjithatë, nga hulumtimi i Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e

---

<sup>23</sup> Lulzim Peci and Agon Demjaha, 'Kosovo - Macro-Drivers of Radicalisation and Violent Extremism', *Connekt* (blog), 5, aksesuar më 4 gusht 2022, <https://h2020connekt.eu/publications/mapping-the-drivers-of-radicalisation-in-the-light-of-state-dynamics-in-kosovo/>.

<sup>24</sup> Lulzim Peci dhe Agon, 5.

<sup>25</sup> Qena, Pyetësor për palët e interesuara të OSHC-ve.

<sup>26</sup> Ardit Orana dhe Skender Perteshi, 'Shkëputja, rehabilitimi dhe riintegrimi i luftëtarëve të huaj terroristë', 10, aksesuar më 12 gusht 2022, <https://qkss.org/en/publikimet/disengagement-rehabilitation-riintegration-foreign-terrorist-fighters>

<sup>27</sup> Ardit Orana dhe Skender Perteshi, 10.

<sup>28</sup> Drejtoria e Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit, 'Raporti për Maqedoninë e Veriut për vitin 2021', 40, aksesuar më 16 gusht 2022, [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/north-macedonia-report-2021\\_en](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/north-macedonia-report-2021_en).

<sup>29</sup> 'Maqedonia e Veriut', *Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara* (blog), aksesuar më 16 gusht 2022, <https://www.state.gov/reports/country-reports-on-terrorism-2020/north-macedonia/>.

<sup>30</sup> "Ngritja e së djathtës: Rasti i Serbisë - Ekstremizmi, Terrorizmi, Luftëtarët e Huaj", *Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Serbi*, 2022, 56,57, <https://www.helsinki.org.rs/serbian/doc/Uspon%20desnice%20-%20slucaj%20Srbija.pdf>

Njeriut në Serbi, niveli i mosbesimit të aktorëve të sigurisë ndaj OSHC-ve shfaqet si sfidë.<sup>31</sup> Pavarësisht kësaj, ka përpjekje në nivel lokal për të adresuar P/KEDh-në, siç është rasti me qendrën DamaD në Novi Pazar-Serbi që ofroi dhe mbështeti krijimin e një mekanizmi referimi që bashkon aktorë të ndryshëm lokalë (p.sh. policinë, prokurorët, shkollat, klubet sportive, institucionet fetare, mediat, OSHC-të).<sup>32</sup>

Ashtu si në rastet e Shqipërisë dhe Bosnjë-Hercegovinës, vitet e fundit po zhvillohet një bashkëpunim më intensiv i organeve të zbatimit të ligjit/sigurisë dhe palëve të tjera të interesuara për çështjet e riadhesimit, riintegritimit dhe rehabilitimit të të kthyerve nga Siria.<sup>33</sup>

### c) Qasjet me shumë agjenci dhe multidisiplinare në BP

Vendet e BP-së pranuan nevojën për një qasje gjithëpërfshirëse ndaj P/KEDh. Për të ofruar në mënyrë efektive shërbimet në kuadër të P/KEDh dhe për të rritur bashkëpunimin midis të gjithë palëve të interesuara, vendet e BP-së miratuan një qasje me shumë agjenci/multidisiplinare që është thelbësore për zbatimin e masave parandaluese për mbrojtjen e qytetarëve nga ekspozimi ndaj ideologjive ekstremiste.

Në paragrafët e mëposhtëm, prezantohen modelet e mekanizmave të referimit që po zhvillohen në vendet e Ballkanit Perëndimor, ku zhvillohet bashkëpunimi dhe përfshirja e agjencive të zbatimit të ligjit/sigurisë me palë të tjera të interesuara.

Kosova është ndër vendet e para në BP që pilotoi një mekanizëm referimi në vitin 2016 në një nga komunat e prekura nga ekstremizmi. Ky mekanizëm referimi në komunën e Gjilanit zbaton një qasje multidisiplinare dhe holistike ndaj përfshirjes së komunitetit dhe punë policore të orientuar drejt komunitetit që përfshin të gjithë sektorët e shoqërisë. Mekanizmi i referimit përdor bashkëpunimin ekzistues midis autoriteteve lokale, policisë dhe komunitetit lokal për të pranuar referime të individëve në rrezik për t'u tërhequr në ekstremizëm të dhunshëm, për të vlerësuar natyrën dhe shtrirjen e këtij rreziku dhe për të zhvilluar mbështetjen më të përshtatshme për individët e interesuar. Megjithatë, mekanizmi i referimit në Gjilan shërben për identifikimin e hershëm të individëve në rrezik apo të cenueshëm ndaj radikalizmit, për të parandaluar radikalizimin e individëve në shoqëri. Prandaj, ai nuk përfshin proceset terciare të risocializimit dhe riintegritimit. Anëtarët e mekanizmit referues janë përfaqësues të nivelit lokal të cilët kanë kontakt të ngushtë me komunitetin në jetën e tyre të përditshme, siç janë zyrtarët komunalë, PK-ja, SHKK-ja, Departamenti i Arsimit, shkollat, Departamenti i Shërbimeve Sociale, komunitetet fetare, psikologët dhe këshillat e prindërve, ndërsa partnerë të jashtëm me të cilët mekanizmi i referimit bashkëpunon në trajtimin e rasteve janë OJQ-të, institucionet e tjera zbatuese, forumet e sigurisë në komunitet, përfaqësuesit e mediave dhe organizatat rinore.<sup>34</sup>

Mekanizmi i referimit ka pesë përgjegjësi kryesore, gjithmonë në përputhje me parimet e konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave:

1. identifikimin e hershëm të individëve në rrezik,
2. vlerësimin e natyrës së rrezikut dhe përcaktimin e masave për trajtimin në formën e një pakete mbështetëse,
3. zbatimin e paketës mbështetëse (masat për trajtim),
4. garantimin që personi ka marrë këshillën dhe mbështetjen e duhur,
5. vlerësimin e efektivitetit të zbatimit të paketës.

---

<sup>31</sup> "Ngritja e së djathtës: Rasti i Serbisë - Ekstremizmi, Terrorizmi, Luftëtarët e Huaj", 46.

<sup>32</sup> "Referalni-Mehanizam-Za-Prevenciju-i-Suzbijanje-Ekstremizma-i-Radikalizma.Pdf", aksesuar më 1 nëntor 2022, <https://www.kcdamad.org/wp-content/uploads/2019/09/Referalni-mehanizam-za-prevenciju-i-suzbijanje-ekstremizma-i-radikalizma.pdf>

<sup>33</sup> Azinoviç, Pyetësor për palët e interesuara nga radhët e ekspertëve.

<sup>34</sup> Intervistë me Luan Kekën.

Procesi i mekanizmit të referimit:

- Procesi i referimit përfshin fazën e identifikimit të personave të cenusshëm ndaj radikalizmit, që bëhet nga aktorë të ndryshëm në shoqëri, të cilët janë trajnuar paraprakisht, veçanërisht në identifikimin e treguesve të rrezikut dhe cenusshmërisë, si policia, anëtarët e familjes, bashkëmoshatarët, mësuesi i shkollës apo psikologu, mjeku i qendrës shëndetësore në lagjen e asaj komune, përfaqësuesit e subjekteve fetare dhe trajnerët sportivë.<sup>35</sup>
- Pas përfundimit të fazës së identifikimit, fillon faza e shqyrtimit të rastit, në të cilën fazë anëtarët e mekanizmit të referimit mbledhin informacione mbi cenusshmërinë e individit ndaj radikalizmit, duke përfshirë vlerësimin e nevojave të individit, si dhe vlerësimin e rrezikut.
- Faza tjetër përfshin referimin për mbështetje, në të cilën fazë bëhet vlerësimi i mbështetjes së ofruar, duke u bazuar në identifikimin e nevojave të individit, vlerësimin e rrezikut dhe përcaktimin e nevojave për mbështetje. Gjatë kësaj faze, anëtarët e mekanizmit referues vendosin me shumicë votash nëse do të vazhdojnë me dhënien e mbështetjes nëse personi është në rrezik. Në rast se vlerësohet se individ i referuar nuk është i cenusshëm ndaj radikalizmit, ose po trajtohet nga ndonjë institucion tjetër, anëtarët e mekanizmit të referimit mund të vendosin të mos vazhdojnë me dhënien e paketës së mbështetjes. Në rastet kur vendoset ofrimi i mbështetjes, anëtarët e mekanizmit referues, duke u bazuar në vlerësimin e nevojave, shqyrtojnë dhe përcaktojnë paketën mbështetëse (Përkufizimi i paketës së mbështetjes) që do t'i ofrohet personit në fjalë, e cila mund të përfshijë asistencë sociale, trajnim profesional, këshillim psikologjik etj.
- Në rastin e dizajnit të një pakete të përshtatshme mbështetëse, personit të referuar i ofrohet ajo paketë (Ofrimi i paketës mbështetëse). Më pas, monitorohet progresi dhe rishikohet cenusshmëria për të përcaktuar nëse paketa ka ofruar mbështetjen e duhur dhe nëse personi mund të dalë nga mekanizmi (Dalja) ose paketa nuk ishte e suksesshme, dhe ky person duhet t'i nënshtrohet procesit të referimit edhe një herë (Kthimi) ose të referohet më tej në institucione të tjera. Në rastet kur ka nivel të lartë rreziku, personi do të referohet në polici për veprime të mëtejshme.

Mekanizmi i referimit në Kosovë konsiderohet si një model i suksesshëm pilot për adresimin e P/KEDh dhe ishte planifikuar të krijohej në komunat e tjera të prekura nga radikalizimi dhe ekstremizmi. Megjithatë, me trendet e shfaqura nga LHT-të e kthyer dhe familjet e tyre, dhe nevojën për të themeluar dhe forcuar Divizionin për Parandalim dhe Riintegrim në kuadër të MPB-së, fokusi ka qenë i orientuar në nivelin qendror, prandaj mekanizmi i referimit nuk ka mundur të zgjerohet në komunat e tjera.<sup>36</sup> Sipas ekspertit lokal, z. Mensur Hoti, planet janë që mekanizmi të zgjerohet edhe në komunat tjera dhe të miratohet mekanizmi i njëjtë referues si në modelin 'Channel' të Mbretërisë së Bashkuar (MB) që po pilotohet në komunën e Hanit të Elezit.

Me krijimin e mekanizmit të referimit, është arritur përfshirja e nivelit vendor dhe qasja multidisiplinare në identifikimin e nevojave dhe zbatimin e programeve për mbrojtjen e individëve të cenusshëm nga ndikimi i ideologjive ekstremiste. Mekanizmi referues i Gjilanit ka mundur bashkëpunim, koordinim dhe komunikim real ndërmjet të gjitha institucioneve në nivel lokal, BIK-ut, e veçanërisht institucioneve arsimore, të cilat kanë rritur komunikimin me prindërit në adresimin e shqetësimeve të tyre dhe koordinimin e aktiviteteve. Përkundër rezultateve të arritura, sipas atyre që janë të përfshirë në menaxhimin e programit, deri në vitin 2018 ai kishte trajtuar 10 raste, ku pothuajse në të gjitha rastet ishte shmangur radikalizimi i mëtejshëm i individëve.<sup>37</sup> Mekanizmi i referimit përballet me sfida, të tilla si mungesa e fondeve të destinuara për zbatimin e programeve parandaluese, si dhe mungesa e përvojës së të gjithë aktorëve brenda mekanizmit të referimit. Sipas raportit vjetor për vitin 2022, atë vit janë trajtuar shtatë raste të të miturve që kanë shfaqur shenja radikalizmi.<sup>38</sup>

---

<sup>35</sup> Luan Keka, Pyetësor për palët e interesuara të qeverisë.

<sup>36</sup> Intervistë me Luan Kekën.

<sup>37</sup> 'Understanding Referral Mechanisms in Preventing and Countering Violent Extremism and Radicalization That Lead to Terrorism', 103, aksesuar më 7 mars 2023, <https://www.osce.org/files/f/documents/7/4/418274.pdf>

<sup>38</sup> Mensur Hoti, Pyetësor për palët e interesuara të qeverisë, 4 gusht 2023.

Mekanizmi referues i Gjilanit fokusohet vetëm në identifikimin e individëve të cenueshëm ndaj ideologjive ekstremiste dhe radikalizmit, ndërsa kthimi i luftëtarëve të huaj dhe familjeve të tyre nga zona e konfliktit ka ngritur nevojën për zhvillimin e programeve në fushën e riintegritit dhe risocializimit, si dhe përfshirjen e OSHC-ve lokale.

Aktualisht, ka filluar transferimi i përgjegjësive nga DPRPR-ja në nivel lokal. Si rezultat i këtij procesi, në komunën e Hanit të Elezit ka filluar zbatimi i mekanizmit të referimit (zgjerimi në komunat e tjera pritet të fillojë së shpejti), bazuar në modelin "Channel" të Mbretërisë së Bashkuar, që do të shtjellohet më poshtë në dokument. Në këtë mekanizëm përfshihen aktorë përkatës nga niveli lokal, si p.sh. ata të shëndetësisë, mbështetjes psikologjike, shërbimeve sociale dhe arsimore, policisë etj..<sup>39</sup> Pas një serie udhëtimesh studimore në Mbretërinë e Bashkuar nga ekipet kosovare qendrore dhe lokale të reagimit të parë të përfshirë në P/KEDh, të cilët mësuan rreth modelit dhe ndoqën trajnime nga ekspertët e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, duke u bazuar në ngjashmëritë që i kanë organet e zbatimit të ligjit në Kosovë në qasjen e tyre të policimit në komunitet me modelin e MB-së dhe mbështetjen e ofruar nga qeveria e MB-së, u mor vendimi për fillimin dhe zbatimin e modelit të "Channel".

Roli i mekanizmit të referimit do të jetë të mbështesë dhe mbrojë personat në rrezik ose të cenueshëm ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit.

Ndryshe nga modeli "Channel" i Mbretërisë së Bashkuar, i cili fokusohet kryesisht tek njerëzit e cenueshëm dhe ata të rrezikuar nga ndikimi i ideologjive ekstremiste, mekanizmi i Hanit të Elezit është gjithashtu i përfshirë në risocializimin dhe riintegrimin e të kthyerve nga zonat e konfliktit, si dhe te personat e liruar nga burgjet pasi janë dënuar për vepra terrorizmi.<sup>40</sup>

### Modeli "Channel" i Mbretërisë së Bashkuar

"Channel" është një program vullnetar, konfidencial që i mbron njerëzit e identifikuar si të cenueshëm për t'u përfshirë në terrorizëm. Është një proces me shumë agjenci, që përfshin punonjësit socialë, shkollat, kolegjet e arsimit të mëtejshëm dhe universitetet, shërbimet mbështetëse për të rinjtë që kanë shkelur ligjin, shërbimet për fëmijët dhe të rriturit, masat mbrojtëse lokale, menaxherët për mbrojtje të autoriteteve lokale (të rritur dhe/ose fëmijë), shërbimet e autoritetit lokal "Ndihma e hershme" (Early Help), Forcat Kufitare të Emigracionit të Ministrisë së Brendshme (Zbatimi i Emigracionit, Vizat dhe Emigracioni në Mbretërinë e Bashkuar), ofruesit e strehimit, burgjet dhe ofruesit e shërbimit të provës.<sup>41</sup>

Përgjegjësitë dhe objektivat e programit "Channel" janë:

- identifikimi i individëve në rrezik,
- vlerësimi i natyrës dhe shkallës së atij rreziku,
- zhvillimi i planit më të përshtatshëm të mbështetjes për individët në fjalë.

Roli i policisë në programin "Channel" është i fokusuar kryesisht në vlerësimin e rrezikut dhe menaxhimin e rrezikut, vlerësim i cili duhet të bëhet krahas vlerësimit të nevojave të subjektit. Gjithashtu, policia, duke pasur parasysh natyrën e punës së saj, shërben si adresë referimi për rastet.

Maqedonia e Veriut, që nga viti 2019, ka filluar me zbatimin e mekanizmit të referimit të njohur si "Passage4prevent", i cili është një mekanizëm me shumë agjenci përgjegjëse për referimet e individëve që

<sup>39</sup> Hoti, Pyetësor për palët e interesuara të qeverisë, 30 korrik 2022.

<sup>40</sup> Hoti.

<sup>41</sup> 'Channel Duty Guidance: Protecting People Vulnerable to Being Drawn into Terrorism', 7, aksesuar më 24 gusht 2022,

[https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment\\_data/file/964567/6.6271\\_HO\\_HMG\\_Channel\\_Duty\\_Guidance\\_v14\\_Web.pdf](https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/964567/6.6271_HO_HMG_Channel_Duty_Guidance_v14_Web.pdf)

janë në rrezik të radikalizimit që mund të çojë në ekstremizëm të dhunshëm. Ky mekanizëm referimi u zhvillua në kuadër të projektit "Eduko për të parandaluar - Forcimi i punonjësve të vijës së parë të shkollave dhe prindërve për të ndërtuar rezistencën e të rinjve ndaj ekstremizmit të dhunshëm", zbatuar nga Qendra për Hulumtim dhe Hartim të Politikave në partneritet me CED dhe NEXUS, i financuar nga BE-ja në kuadër të Programit Global STRIVE të menaxhuar nga Qendra Hedayah e Ekselencës për Luftimin e Ekstremizmit të Dhunshëm.<sup>42</sup>

Ky është një model i mekanizmit të referimit që është i ankoruar në nivel komuniteti dhe parashikon një strukturë me shumë agjenci që mundëson vlerësimin e rrezikut dhe mbështetjen e individit nga këndvështrime të ndryshme: psikologjike, arsimore, sociale, shëndetësore, kulturore dhe fetare. "Passage4prevent" nuk përfshin krijimin e një mekanizmi të veçantë, por është vetëm një përmirësim i mekanizmave ekzistues në nivel lokal të dedikuar për çështje të tjera, siç është mekanizmi kundër dhunës në familje, me një ndryshim të vetëm: policia nuk ka qasje të drejtpërdrejtë të referuarit, pasi ekstremizmi konsiderohet një fazë para-kriminale.<sup>43</sup>

Në kuadër të granteve të Fondit Global për Përfshirjen dhe Rezistencën e Komunitetit (GCERF) për ngritjen e kapaciteteve dhe ndihmë për LHT-të e kthyer dhe familjet e tyre (mbështetje psikosociale dhe zhvillim aftësish), një konsorcium i OShC-ve të Maqedonisë së Veriut është i angazhuar në aktivitete të ndryshme në P/KEDh dhe RdheR.<sup>44</sup> Një shembull i OShC-ve është edhe NEXUS, i përfshirë në aktivitete të tilla si hartimi i dokumenteve si më poshtë:

- monitorimi dhe vlerësimi i strategjive ekzistuese dhe planeve të veprimit;
- kontributi aktiv në hartimin e strategjive të reja kombëtare për KEDh dhe LT dhe planet e tyre të veprimit,
- organizimi i ngjarjeve në komunitet brenda komunave të caktuara, ku jetojnë LHT-të e kthyer dhe familjet e tyre, me tema të ndryshme, të tilla si format e ndryshme të dhunës, të drejtat themelore të fëmijëve, të drejtat për RdheR të kategorive të cënueshme dhe ndërgjegjësimi i komuniteteve për riintegrimin e ish-shkelësve të dhunshëm ekstremistë dhe familjeve të tyre;
- përgatitja dhe hartimi i kompletit të dokumenteve, për punonjësit e vijës së parë, në përputhje me Planin Kombëtar për RdheR dhe në konsultim me Komitetin Kombëtar dhe ekipet lokale multidisiplinare:
  - pyetësor për vlerësimin e shkallës së radikalizimit të individit që është pjesë e procesit të RdheR,
  - protokoli standard i verimit për punën me të kthyerit dhe familjet e tyre,
  - doracak i simboleve që i referohen radikalizimit të hershëm në komunitet,
  - model i standardizuar i qasjes për rehabilitimin, risocializimin dhe riintegrimin e luftëtarëve që kthehen nga zonat e huaja të luftës dhe familjeve të tyre,
  - modeli i standardizuar i qasjes ndaj KEDh,
  - Doracak 1: Radikalizmi dhe radikalizimi: konceptet bazë dhe karakteristikat e dukurisë,
  - Doracak 2: Parandalimi i radikalizimit
  - Doracak 3: Rehabilitimi nga ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizimi.

---

<sup>42</sup> 'Passage4Prevent-Prelom-Ang.Pdf', 5, aksesuar më 16 gusht 2022, <http://www.crpm.org.mk/wp-content/uploads/2019/07/Passage4Prevent-prelom-ang.pdf>

<sup>43</sup> 'Passage4Prevent-Prelom-Ang.Pdf', 18.

<sup>44</sup> 'Maqedonia e Veriut', GCERF (blog), 5 janar 2022, <https://www.gcerf.org/north-macedonia/>.

Këto dokumente nuk janë të disponueshme publikisht dhe janë vetëm për përdorim të brendshëm të Komitetit Kombëtar<sup>45</sup> për KEDh dhe LT, si dhe për të gjitha ato institucione dhe organe kombëtare që punojnë në këtë çështje.<sup>46</sup>

Serbia, që nga viti 2018, ka filluar të zbatojë mekanizmin e referimit me shumë agjenci në nivel lokal (komuna e Novi Pazarit). Mekanizmi referues për parandalimin dhe kontrollin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm është një kornizë e plotë për veprim institucional dhe përmirësimin e bashkëpunimit të aktorëve të ndryshëm shoqërorë në Novi Pazar (institucionet dhe shërbimet, organet, pushtetet lokale, komunitetet fetare, OJQ-të, mediat dhe të tjera), duke u bazuar në mandatet dhe përgjegjësitë ekzistuese. Qëllimi i mekanizmit të referimit është puna parandaluese/proaktive për parandalimin dhe eliminimin e rreziqeve dhe ndihmën dhe ofrimin e mbështetjes për fëmijët dhe të rinjtë kur ata janë të ekspozuar ndaj rrezikut të radikalizmit, puna reaktive/ndërrhyrëse për njohjen e hershme të lidhjeve të mundshme me ekstremizmin dhe radikalizmin, dhe reagimi efektiv përpara se të kryhet një vepër penale.

Qëllimi kryesor i mekanizmit të referimit është që:

- të sigurojë respektimin e të drejtave të njeriut të fëmijëve/të rinjve në rrezik ose të lidhur me ekstremizmin dhe radikalizmin, të sigurojë një mënyrë efektive të ofrimit të shërbimit brenda çdo institucioni;
- të mundësojë referimin/referimin tek ofruesit e tjerë të shërbimeve, kurdoherë që është në interesin më të mirë të fëmijës/të riut, dhe referimin te organi koordinues i qytetit, nëse sistemi i shërbimit nuk është në gjendje ta përpunojë vetë rastin;
- të sinkronizojë përpjekjet për të përmirësuar politikat lokale dhe procedurat për një spektër të gjerë sfidash, rreziqesh dhe kërcënimesh ndaj sigurisë njerëzore dhe sigurisë shoqërore në komunitetin lokal;
- të mbledhë të dhëna për shërbimet e ofruara dhe të identifikojë nevojat për të përmirësuar sistemin e hartimit të politikave publike në lidhje me çështjet e ekstremizmit dhe radikalizmit.<sup>47</sup>

Aktorët relevantë që marrin pjesë në mekanizmin e referimit ndahen në dy grupe kryesore: **Aktorët parësorë** janë institucionet/organizatat që punojnë drejtpërdrejt ose takohen me fëmijët dhe të rinjtë, dhe në baza ditore ofrojnë lloje të ndryshme shërbimesh sipas mandatit të tyre. Të gjithë aktorët kryesorë mund të jenë pika e kontaktit të parë - një pikë hyrëse në sistemin e ofrimit të shërbimeve (policia në komunitet, shkollat, bashkësitë fetare, qendrat për punë sociale, shoqatat sportive, institucionet shëndetësore, prokuroria, gjykatat, OJQ-të dhe mediat). **Aktorët dytësorë** janë politikëbërësit dhe vendimmarrësit, organet dhe trupat që mund të ndikojnë në cilësinë e ofrimit të shërbimeve nëpërmjet shpërndarjes së fondeve buxhetore dhe vendimeve të tjera strategjike (qyteti i Novi Pazarit, Këshilli Lokal i Sigurisë, Këshilli për Barazinë Gjinore, Ministria e Kulturës, Ministria e Arsimit, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, etj).<sup>48</sup> Roli i policisë brenda mekanizmit të referimit është i fokusuar kryesisht në Policinë e Komitetit, e cila shërben kryesisht si pikë kontakti për referimin e rasteve nga qytetarët dhe aktorët e tjerë për referim të rasteve.

## Sfidat dhe nevojat

Duke parë strukturën institucionale dhe kuadrin ligjor të vendeve të BP-së, vërejmë se të gjitha vendet kanë miratuar një kuadër ligjor dhe dokumente strategjike kombëtare dhe kanë miratuar plane veprimi për P/KEDh. Në shumicën e vendeve, këto strategji janë në proces të rishikimit ose janë rishikuar dhe ri-hartuar. Të gjitha vendet e BP-së janë palë në *Planin e Përbashkët të Veprimit kundër Terrorizmit në Ballkanin*

---

<sup>45</sup> Në Komitet janë të përfaqësuar institucionet kyçe që luftojnë terrorizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm si p.sh. përfaqësues nga të gjitha ministrinë (veçanërisht shëndetësia, arsimi, kultura dhe çështjet sociale), policia dhe shërbimi i inteligjencës.

<sup>46</sup> Afroditë Musliu, Pyetësor për palët e interesuara të OSHC-ve, pa datë

<sup>47</sup> 'Referalni-Mehanizam-Za-Prevenciju-i-Suzbijanje-Ekstremizma-i-Radikalizma.Pdf', 13.

<sup>48</sup> 'Referalni-Mehanizam-Za-Prevenciju-i-Suzbijanje-Ekstremizma-i-Radikalizma.Pdf', 15.

*Perëndimor*<sup>49</sup> që parashikon një plan gjithëpërfshirës me pesë objektiva të ndryshëm për përmirësimin e kapaciteteve, legjislacionit dhe për harmonizimin e politikave duke e theksuar edhe P/KEDh-në.<sup>50</sup>

Organi i zbatimit të ligjit (policia) dhe aktorë të tjerë të sigurisë luajnë një rol kritik në P/KEDh në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor; kjo është edhe për shkak të qasjes së bazuar në siguri të qeverive në të kaluarën për t'u marrë me ekstremizmin e dhunshëm dhe LT, por edhe për shkak të nivelit ekzistues të kapaciteteve të organeve të zbatimit të ligjit, pasi ato duhet të merren me çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes në komunitetit.

Në pjesën më të madhe, policia dhe aktorët e tjerë të sigurisë në BP janë të përfshirë kryesisht në parandalimin terciar dhe dytësor.<sup>51</sup> Struktura institucionale dhe kuadri ligjor i shumicës së vendeve të Ballkanit Perëndimor, në përgjithësi, mundësojnë avancimin e rolit të policisë dhe përmirësimin e bashkëpunimit në P/KEDh me palët e tjera të interesuara edhe pse është e nevojshme të bëhen ndërhyrje në legjislacionin primar dhe dytësor. Për më tepër, vihet re se edhe pse ka stimuj në disa bashki/komuna në të gjithë Ballkanin Perëndimor duke krijuar mekanizma multi-sektorialë ose multidisiplinarë për t'u marrë me P/KEDh, sfidat që duhen konsideruar dhe adresuar janë si më poshtë.

### Sfidat kryesore në P/KEDh

- mungesa e besimit ndaj segmenteve të shoqërisë civile dhe palëve të tjera të interesuara, siç janë institucionet në nivel qendror dhe lokal, të cilët nuk janë të përfshirë drejtpërdrejt në çështjet e sigurisë, si psikologët, psikiatrit, punonjësit socialë dhe punëtorët komunalë;
- kapacitetet e pamjaftueshme në nivel lokal si p.sh. burime të kufizuara të zyrtarëve të provës, punonjësve socialë, psikologëve në shkolla;
- mungesa e procedurave dhe metodave sistematike për vlerësimin e rrezikut ndërmjet palëve të interesuara përgjegjëse për P/KEDh;
- mungesa e shkëmbimit të informacionit ndërmjet organeve të zbatimit të ligjit/policisë, praktikuesve të nivelit lokal dhe OSHC-ve;
- mungesa e protokolleve të përbashkëta për komunikim dhe bashkëpunim ndërinstitucional;<sup>52</sup>
- paqëndrueshmëria politike në vendet e Ballkanit Perëndimor;
- mungesa e ndjeshmërisë dhe ndërgjegjësimit për çështjet e lidhura me P/KEDh-në në mesin e policisë;<sup>53</sup>
- mungesa e mekanizmave efektivë për monitorimin dhe vlerësimin e koordinimit dhe zbatimit të aktivitetëve;<sup>54</sup>
- sfida e qëndrueshmërisë, mungesa e fondeve specifike të dedikuara për mekanizmat;
- të emëruarit politikë në qendrat kombëtare të KEDh e pengojnë vazhdimësinë e punës së shumë agjencive pas ndryshimit të qeverisë.

<sup>49</sup> Komisioni Evropian, 2018, Plani i Përbashkët i Veprimit kundër Terrorizmit në Ballkanin Perëndimor, [https://home-affairs.ec.europa.eu/system/files/2018-10/20181005\\_joint-action-plan-counter-terrorism-western-balkans.pdf](https://home-affairs.ec.europa.eu/system/files/2018-10/20181005_joint-action-plan-counter-terrorism-western-balkans.pdf)

<sup>50</sup> Arber Fetiu dhe Diana Mishkova, '31.12.2020 Diana Mishkova, Simeon Evstatiev', pa datë, 6, <https://www.prevev-balkan-mena.eu/wp-content/uploads/2021/01/D5.1-Policy-brief-the-Balkans-1.pdf>

<sup>51</sup> 'NSCITF-Report-on-Countering-Violent-Extremism.Pdf', n.d., 15,16.

<sup>52</sup> <http://www.crpm.org.mk/wp-content/uploads/2019/07/Passage4Prevent-prelom-ang.pdf>, 18.

<sup>53</sup> Qena, Pyetësor për palët e interesuara të OSHC-ve.

<sup>54</sup> Fetiu dhe Mishkova, '31.12.2020 Diana Mishkova, Simeon Evstatiev', 18.

## Forcimi i rolit dhe bashkëpunimit të organeve të zbatimit të ligjit me aktorë të tjerë në P/KEDh në të gjithë BP

Në të gjithë BP-në, organi i zbatimit të ligjit, përkatësisht policia, është pjesë e grupeve të punës me shumë agjenci në fushën e parandalimit të radikalizimit që çon në ekstremizëm të dhunshëm dhe terrorizëm - qoftë përmes policimit në komunitet, KKS-ve, KLS-ve ose mekanizmave të referimit në nivel lokal, dhe në nivel qendror me anëtarë të specializuar në LT dhe inteligjencë.

Policia në këto mekanizma me shumë agjenci mund të luajë një rol të rëndësishëm. Disa nga fushat ku policia mund të bashkëpunojë me aktorë të tjerë dhe në të njëjtën kohë të kontribuojë, përfshijnë: proceset e riatdhesimit të LHT-ve dhe familjeve të tyre, menaxhimin e rrezikut dhe risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin.

- Menaxhimi i rrezikut dhe risocializimi<sup>55</sup>

Roli dhe përgjegjësia e policisë për krijimin e një mjedisi të sigurt dhe të mbrojtur në komunitet jep avantazhin e krijimit të besimit dhe mundësinë e ndikimit në komunitet, veçanërisht përmes punës policore në komunitet, ndërveprimit me institucionet lokale dhe nivele të ndryshme në komunitet për të ofruar një mjedis të sigurt dhe të mbrojtur. Prandaj, këta faktorë e vendosin policinë në një rol të rëndësishëm në menaxhimin e rrezikut dhe risocializimin e ish-shkelësve ekstremistë të liruar të dhunshëm. Edhe pse menaxhimi i rrezikut dhe risocializimi nuk bien nën përgjegjësinë e policisë, as në fazën e para-lirimit të shkelësve të ligjit deri sa janë në burg e as pas lirimit, policia mund të luajë një rol në bashkëpunim me shërbimet e burgjeve dhe shërbimet e provës. Në fazat e hershme të ndalimit të shkelësit, policia mund të ndajë vlerësimet individuale të rrezikut/kërcënimit të shkelësve të dhunshëm ekstremistë me shërbimet e burgut. Këto vlerësime do t'u shërbejnë shërbimeve të burgut për të përshtatur programet individuale për deradikalizimin në burg dhe për të menaxhuar shqetësimet e sigurisë brenda burgut. E njëjta procedurë dhe bashkëpunim mund të përdoret së bashku me shërbimet e provës në fazën e para-lirimit dhe pasi shkelësi të lirohet nga burgu. Për më tepër, pozicioni unik që ka policia në komunitet, si ofrimi i sigurisë dhe mbrojtjes për komunitetin në baza ditore, ndërveprimi me aktorët kryesorë lokalë në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, qasja dhe përfshirja në nivele të ndryshme të komunitetit, e vendos policinë në një pozicion të favorshëm për të kontribuar në procesin e menaxhimit të rrezikut dhe risocializimit të ish-shkelësve ekstremistë të dhunshëm të liruar.<sup>56</sup>

Siç u përmend më lart, menaxhimi i rrezikut dhe risocializimi bien nën përgjegjësinë e shërbimit të burgjeve dhe programet brenda burgjeve për deradikalizimin mund të kryhen gjithashtu në bashkëpunim me OJQ-të dhe OSHC-të. Në këtë kontekst, roli i policisë, edhe në bazë të legjislacionit në vendet e Ballkanit Perëndimor, nuk parashikon përfshirje brenda burgjeve. Megjithatë, ekzistojnë modele ku policia ka një rol në fazën e para-lirimit, si në rastin Aarhus në Danimarkë. Kjo qasje i mundëson policisë lokale të kryejë vizita në burg te të burgosurit, gjë që mundëson krijimin e një marrëdhënieje besimi në një fazë të hershme të procesit të deradikalizimit dhe risocializimit gjatë vuajtjes së dënimit në burg dhe e cila marrëdhënie mund të zhvillohet dhe të vazhdojë edhe pas lirimit nga burgu.<sup>57</sup> Po ashtu, kjo metodë veprimi i jep policisë informacion të vlefshëm që mund ta ndajë me punonjësit socialë të përfshirë në proces pas lirimit të shkelësit dhe e lehtëson procesin e riintegrimit të subjektit në komunitet.

---

<sup>55</sup> 'GCERF-Strategy-for-Investment-in-the-Western-Balkans.Pdf', 3, aksesuar më 3 shkurt 2023, <https://www.gcerf.org/wp-content/uploads/2015/12/GCERF-Strategy-for-Investment-in-the-Western-Balkans.pdf>

<sup>56</sup> [https://homeaffairs.ec.europa.eu/system/files/201906/ran\\_pol\\_role\\_do\\_police\\_play\\_in\\_resocialisation\\_marseille\\_20190520\\_en.pdf](https://homeaffairs.ec.europa.eu/system/files/201906/ran_pol_role_do_police_play_in_resocialisation_marseille_20190520_en.pdf), 4.

<sup>57</sup> [https://home-affairs.ec.europa.eu/system/files/2019-06/ran\\_pol\\_role\\_do\\_police\\_play\\_in\\_resocialisation\\_marseille\\_20190520\\_en.pdf](https://home-affairs.ec.europa.eu/system/files/2019-06/ran_pol_role_do_police_play_in_resocialisation_marseille_20190520_en.pdf), 4.



### Modeli Aarhus – Danimarkë<sup>58</sup>

Ky model ofron ndërhyrje në dy nivele: i drejtohet si popullatës së përgjithshme ashtu edhe individëve.

Ndërhyrja te popullsia e përgjithshme:

- Rritja e ndërgjegjësimit të praktikuesve dhe publikut nëpërmjet takimeve informuese dhe punëtorive për profesionistët dhe institucionet mësimore.
- Përfshin bashkëpunimin me komunitetet lokale. Përfshin dialog të respektueshëm dhe të sigurt/me vetëbesim me subjektet fetare, shoqatat kulturore dhe aktorët e tjerë kryesorë në komunitetet lokale.

Ndërhyrja te individët:

- Stafi i linjës së parë të Task Forcës kryen vlerësimet e rrezikut të individëve dhe grupeve.
- Stafi profesional këshillohet për trajtimin e rasteve të lidhura me radikalizimin.
- Këshillimi ofrohet për individë dhe familje në rastet e radikalizimit.
- Mentorimi ofrohet për individët në rrezik të radikalizimit ose përfshirjes në ekstremizëm të dhunshëm.
- Përgatiten plane emergjente për luftëtarët e huaj dhe familjet e tyre.

Ky model konsiderohet i thjeshtë, i lehtë për t'u zbatuar, veçanërisht në komunat e vogla dhe, çka është më e rëndësishme, minimizon stigmatizimin e komuniteteve të caktuara. Prandaj, vlerësojmë se ky është një nga modelet e shumta që mund të përdoret për vendet e Ballkanit Perëndimor.

- Riatdhesimi, riintegrimi dhe rehabilitimi

Siç u përmend në seksionin e mësipërm, organet e zbatimit të ligjit së bashku me aktorë të tjerë, si p.sh. OSHC-të, komuniteti lokal, përfaqësuesit fetarë, mediat, etj., kanë një rol thelbësor në Ballkanin Perëndimor në luftën kundër terrorizmit si dhe në P/KEDh. Në kontekstin aktual, policia ka një rol kritik në riadhesimin e LHT-ve, veçanërisht në vlerësimin e kërcënimeve dhe koordinimin e procesit të kthimit të LHT-ve dhe familjeve të tyre nga Siria.

I tillë ishte rasti, veçanërisht për vendet e Ballkanit Perëndimor, Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut dhe Kosovën, që ndërmeren operacione për riadhesimin e qytetarëve (LHT-ve dhe familjeve të tyre) nga Siria. Po kështu, policia është një nga aktorët kryesorë në menaxhimin dhe vlerësimin e rrezikut në bashkëpunim me burgjet dhe shërbimin e provës në fazën e para-lirimit. Ndërsa në fazën e pas-lirimit, si në rastin e Kosovës, ajo bashkëpunon nga afër me mekanizmin multidisiplinar për riintegrim dhe rehabilitim përmes DPRPR-së në MPB).<sup>59</sup>

Ky bashkëpunim ndodh veçanërisht në parandalimin terciar,<sup>60</sup> ku synohet që nëpërmjet programeve të përshtatura të arrihen objektivat e përbashkëta për shkëputjen, deradikalizimin, riintegrimin dhe rehabilitimin e shkelësve të dhunshëm ekstremistë terroristë, LHT-ve të kthyer dhe anëtarëve të familjeve të tyre.

Për të arritur rezultatet e dëshiruara në DPRPR, policia ka caktuar oficerë policie me njohuri, përvojë dhe aftësi adekuate për të trajtuar rastet e P/KEDh-së dhe për të punuar së bashku me aktorë të tjerë institucionalë dhe shoqërinë civile. Policia ka dhënë informacionin e nevojshëm për subjektet dhe vlerësimet

<sup>58</sup> 'Modeli Aarhus: Parandalimi i Radikalizimit dhe Diskriminimit në Aarhus', aksesuar më 16 tetor 2022, [https://home-affairs.ec.europa.eu/networks/radicalisation-awareness-network-ran/collection-inspiring-practices/ran-practices/aarhus-model-prevention-radicalisation-and-discrimination-aarhus\\_en](https://home-affairs.ec.europa.eu/networks/radicalisation-awareness-network-ran/collection-inspiring-practices/ran-practices/aarhus-model-prevention-radicalisation-and-discrimination-aarhus_en)

<sup>59</sup> Divizioni i Parandalimit dhe Riintegritit, Ministria e Punëve të Brendshme, Kosovë.

<sup>60</sup> 'NSCITF-Report-on-Countering-Violent-Extremism.Pdf', 2.

e rrezikut për praktikuesit e tjerë që duhet të ndërhyjnë në bazë të nevojave dhe kërkesave. Nga ana tjetër, policia ka përfituar nga ky mekanizëm multidisiplinar pasi është informuar më shumë për profilin psikologjik të subjektit nëpërmjet shërbimeve të shëndetit mendor dhe ka marrë njohuri mbi komunitetin pritës, familjen dhe aspektet sociale ku subjekti është riintegruar. Kjo ka ndihmuar policinë dhe aktorët e sigurisë të planifikojnë më mirë sigurinë e komunitetit.

Edhe në nivel lokal, policia, nëpërmjet mekanizmave të referimit atje ku janë krijuar, nga KLS-të dhe KKS-të, luan një rol të rëndësishëm në P/KEDh. Në të gjithë këta mekanizma në nivel lokal, policia nuk ka një rol udhëheqës, por kontribuon nëpërmjet ekspertizës që ka për trendet dhe dukuritë në komunitet dhe njohuritë për komunitetin. Policia është e përfshirë kryesisht në këto mekanizma nëpërmjet punës policore në komunitet. Në hulumtimet e deritanishme në BP, vihet re rëndësia e bashkëpunimit ndërmjet policisë dhe aktorëve të tjerë në P/KEDh. Megjithatë, nevojiten hulumtime të mëtejshme dhe vlerësime adekuate për rezultatet e arritura, ndikimin e këtij bashkëpunimi në shoqëri dhe, më e rëndësishmja, nëse është arritur qëndrueshmëria në këto mekanizma.

Në fushën e RdheR, OJQ-të ndërkombëtare në vendet e Ballkanit Perëndimor në bashkëpunim me përfaqësues të shoqërisë civile nga vendet e BP-së, si Bosnja dhe Hercegovina, Kosova dhe Maqedonia e Veriut, kanë përfituar nga projekti DRIVE i krijuar nga BE-ja, i cili është një projekt i financuar nga Evropa dhe synon zbutjen e kërcënimeve që lidhen me luftëtarët e huaj dhe ekstremistët islamikë nëpërmjet përmirësimit të praktikave të shkëputjes efektive, rehabilitimit dhe riintegrit (ShRR) duke u bazuar në trajtimin me në qendër njeriun dhe përfshirjen e komuniteteve lokale dhe aktorëve publikë. Për këtë qëllim, projekti DRIVE synon identifikimin dhe përhapjen e praktikave dhe politikave më të mira në lidhje me programet ShRR, veçanërisht në vendet e Ballkanit Perëndimor, dhe forcimin e këtyre praktikave nëpërmjet zhvillimit të moduleve specifike të trajnimit dhe fushatave të synuara të shpërndarjes.<sup>61</sup>

Bazuar në qasjen e përfshirjes së gjithë shoqërisë, projekti DRIVE është përshtatur për të synuar aktorë dhe palë të ndryshme të interesuara, duke përfshirë politikëbërësit kombëtarë dhe lokalë, institucionet shtetërore, OSHC-të, punonjësit socialë, organizatat rinore, institucionet e sigurisë dhe të zbatimit të ligjit, aktorët fetarë, shërbimet korrigjuese dhe të provës.

### Projekti DRIVE në Maqedoninë e Veriut

Partner për zbatimin e aktiviteteve në kuadër të projektit DRIVE në Maqedoninë e Veriut është OJQ-ja NEXUS - Koncepti Civil, qëllimi themelor i së cilës është promovimi dhe avancimi i demokracisë.

Në kuadër të këtij projekti, NEXUS është angazhuar në:

- publikimin e hulumtimeve dhe analizave mbi kategoritë e cënueshme (gratë dhe të miturit) bazuar në kontekstin e Maqedonisë së Veriut dhe duke bërë krahasim me vendet e tjera partnere.
- ofrimin e trajnimit "Forcimi i kapaciteteve të punëtorëve të vijës së parë (anëtarë të ekipeve multidisiplinare) për të parandaluar radikalizimin që mund të çojë në dhunë dhe për të ndihmuar në rehabilitimin dhe riintegrimin e ekstremistëve të dhunshëm, LHT-ve të kthyer dhe anëtarëve të familjeve të tyre (gra dhe fëmijë)."<sup>62</sup>

- Role të tjera të organeve të zbatimit të ligjit/sigurisë për të rritur bashkëpunimin me palët e interesuara

Organet e zbatimit të ligjit/sigurisë, siç u shpjegua më sipër, janë të përfshira në qasje të ndryshme me shumë agjenci për të parandaluar radikalizmin dhe ekstremizmin që çojnë në terrorizëm. Prandaj, përveç roleve të shpjeguara më sipër, ata kanë edhe role dhe përgjegjësi të tjera me të cilat kontribuojnë në rritjen

<sup>61</sup> 'Projekti - MARTE - Metodologjia, Objektivat, Rezultatet e Pritshme', *DRIVE* (blog), aksesuar më 9 mars 2023, <https://drive-ontherightpath.eu/the-project/>

<sup>62</sup> Afrodita Musliu, Pyetësori për palët e interesuara të OSHC-ve.

e bashkëpunimit dhe arritjen e objektivave në të gjithë procesin e P/KEDh-së Më poshtë janë dhënë disa nga rolet që i kryejnë organet e zbatimit të ligjit/sigurisë:

- për shkak të afërsisë së tyre me komunitetin, ata bëjnë gjithashtu **identifikimin e hershëm dhe paralajmërimin e hershëm** të personave që mund të jenë të cenueshëm ndaj radikalizimit dhe tendencave në komunitet në lidhje me rreziqet e radikalizimit dhe ekstremizmit;
- rrisin **ndërgjegjësimin** së bashku me palët e tjera të interesit në komunitet për të rritur rezistencën e komunitetit;
- bëjnë **vlerësime të rrezikut** për personat që janë të cenueshëm ndaj ideologjive ekstremiste dhe radikalizmit, si dhe **vlerësime individuale** për personat që tashmë janë prekur nga radikalizmi.

---

*“Policia nuk i ka të gjitha informacionet dhe policia nuk mund ta bëjë punën vetëm... Policia nuk duhet të shpenzojë burime për një detyrë që mund të kryhet më mirë nga dikush tjetër.”<sup>63</sup>*

---

#### **Modeli i Kosovës për RdheR<sup>64</sup>**

Që nga viti 2018, Kosova ka krijuar një udhëzues programi për RdheR për personat e radikalizuar, personat e cenueshëm dhe veçanërisht për LHT-të e kthyer dhe familjet e tyre. **Elementet kryesore të këtij programi janë:**

- a) mbështetja socio-ekonomike,
- b) mbështetja psikologjike,
- c) mbështetje teologjike ose ideologjike,
- d) këshillimi familjar,
- e) mbështetja përmes aktiviteteve rekreative dhe kulturore,
- f) mentorimi.

Ky program zbatohet nga DPRPR-ja në bashkëpunim me ekipin multidisiplinar në nivel qendror dhe lokal dhe është i mbështetur nga OSHC-të e nivelit qendror dhe lokal, të cilat mbështeten nga donatorë të jashtëm si GCERF-i, IOM-i dhe BE-ja, dhe nga ambasada të ndryshme (SHBA-të, Holanda dhe Mbretëria e Bashkuar) të akredituara në Kosovë.

#### **Pjesë e grupeve multidisiplinare në nivel qendror janë:**

- a) Koordinatori Kombëtar Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Terrorizmit
- b) Divizioni për Parandalimin e Radikalizmit dhe Riintegrim
- c) Policia e Kosovës
- d) Shërbimi korrektues
- e) Shërbimi i provës
- f) Psikologët dhe psikiatrit
- g) Organizatat joqeveritare
- h) Shoqëria civile
- i) Predikuesit fetarë dhe teologët

---

<sup>63</sup> [https://home-affairs.ec.europa.eu/system/files\\_en?file=2020-09/ran\\_pol\\_role\\_for\\_police\\_officers\\_utrecht\\_212016\\_en.pdf](https://home-affairs.ec.europa.eu/system/files_en?file=2020-09/ran_pol_role_for_police_officers_utrecht_212016_en.pdf)

<sup>64</sup> Hoti, Pyetësor për palët e interesuara të qeverisë, 30 korrik 2022.

Sipas programeve të udhëhequra nga DPRPR-ja, më shumë se 400 individë janë trajtuar, dhe të gjitha ndërhyrjet janë bërë duke u bazuar në vlerësimet e nevojave individuale dhe vlerësimet e rrezikut.

Në zbatimin e programit të RdheR, DPRPR-ja ka një rol parësor, ndërsa qëllimi i qeverisë është që përgjegjësia të transferohet në nivelin lokal, ku po krijohen ekipe multidisciplinare.<sup>65</sup>

### **Niveli lokal**

Niveli qendror po bashkëpunon me nivelin lokal në trajtimin e rasteve dhe adresimin e P/KEDh-së, forcimin e rolit të tyre në ngritjen e kapaciteteve dhe identifikimin e personave përgjegjës në krijimin e ekipeve multidisciplinare përmes projekteve pilot që do të mbikëqyrnin P/KEDH-në dhe RdheR-në. Siç u diskutua më lart, një projekt i tillë po zbatohet në komunën e Hanit të Elezit, me mbështetjen e Mbretërisë së Bashkuar duke u bazuar në modelin "Channel".<sup>66</sup> Një listë shembullore e pozicioneve për t'u përfshirë në ekipin multidisiplinar janë:

- a) përfaqësuesi i Drejtorisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale,
- b) përfaqësues nga Drejtoria Komunale e Arsimit,
- c) përfaqësuesi i Drejtorisë për Rini, Kulturë dhe Sport,
- d) përfaqësuesi i Drejtorisë së Shëndetit Publik,
- e) përfaqësuesi i Shërbimit të Provës,
- f) përfaqësuesi i Policisë në Komunitet,
- g) përfaqësues të shoqërisë civile,
- h) përfaqësues nga bashkësitë fetare.

Më poshtë është dhënë një shembull i përfshirjes së aktorëve të ndryshëm në RdheR dhe detyrat e tyre:

Personi X (LHT) kthehet nga Siria me gruan dhe fëmijët e tij.

Personi X (FTF) do të trajtohet sipas Kodit Penal nëpërmjet sistemit të drejtësisë.

- Policia bën një kontroll sigurie dhe vlerësim të rrezikut.

### **DPRPR-ja së bashku me ekipin multidisiplinar bën vlerësime në lidhje me ekspertizën përkatëse:**

- punonjësit socialë skanojnë situatën socio-ekonomike,
- mjekët bëjnë vlerësimin mjekësor,
- psikiatrit bëjnë vlerësimin psikiatrik,
- përfaqësuesit fetarë ose teologët bëjnë vlerësimin ideologjik.

Bazuar në gjetjet, përgatitet një program i përgjithshëm RdheR për familjen dhe për çdo fëmijë sipas nevojave të veçanta.

Më pas Ekipet Lokale për Parandalim dhe Riintegrim i zbatojnë aktivitetet.

### **Për shembull, për familjen:**

- në bazë të nevojës, mbështetje sociale dhe ekonomike, strehim, arsim, veshje, etj.

### **Për shembull, për fëmijët:**

- aktivitete të ndryshme rekreative, sportive dhe kulturore,
- regjistrim në shkollë dhe ofrim i programit për mësim për të arritur në nivelin e bashkëmoshatarëve,

<sup>65</sup> Hoti, Pyetësor për palët e interesuara të qeverisë.

<sup>66</sup> Hoti, Pyetësor për palët e interesuara të qeverisë, 30 korrik 2022.

- sesione me psikologë dhe psikiatra, etj.

**Për gratë:**

- trajtim psikiatrik dhe psikologjik,
- punëtori mbi tema të ndryshme si prindërimi,
- trajnim profesional për punësim ose vetëpunësim,
- grante për vetëpunësim, etj.

Gjatë gjithë procesit, shoqëria civile është e përfshirë së bashku me palë të tjera të interesuara. Në varësi të kapaciteteve të OJQ-ve, përfshirja e tyre mund të fokusohet në aspektin e mbështetjes psikosociale, ndihmës në arsim dhe përgatitjes profesionale, ndihmës për vetëpunësim nëpërmjet granteve, apo edhe nëpërmjet aktiviteteve të tjera arsimore dhe kulturore, për të lehtësuar procesin e ndarjes së subjekteve nga ekstremizmi dhe dhuna, apo edhe për sensibilizimin e tyre për përfitimet nga programet e RdheR. Roli i OJQ-ve dhe segmenteve të tjera të shoqërisë civile mund të jetë më efikas në programet RdheR, veçanërisht për disa kategori më të ndjeshme, si gratë dhe fëmijët.<sup>67</sup>

Me bashkëpunimin ndërmjet aktorëve institucionalë dhe OSHC-ve në hartimin e dokumenteve strategjike dhe programeve për RdheR, është konstatuar se aktivitetet zbatuese kanë qenë më të drejtpërdrejta dhe të koordinuara mirë. Kjo çoi gjithashtu në ngritjen e kapaciteteve dhe mundësive për zbatimin e programeve të RdheR.

Megjithatë, edhe pse është arritur një praktikë e mirë e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet aktorëve institucionalë dhe shoqërisë civile në RdheR, çështja e financimit të qëndrueshëm **mbetet sfidë**, pasi një pjesë e rëndësishme e programeve të RdheR vazhdon të bazohet në donacionet ndërkombëtare.

Paragrafi i mëposhtëm e thekson bashkëpunimin e institucioneve me aktorët e shoqërisë civile në zbatimin e aktiviteteve për arritjen e objektivave të P/KEDh.

Fakti që OSHC-të janë të përfshira në P/KEDh dhe RdheR në bashkëpunim dhe koordinim me aktorë të tjerë të zbatimit të ligjit konfirmohet edhe nga intervistat me palët e interesuara që i përfaqësojnë OSHC-të dhe zyrtarët e institucioneve shtetërore. Për të zbatuar aktivitetet me sukses dhe për të vlerësuar nevojat individuale të LHT-ve të kthyer dhe familjeve të tyre, policia përmes DPRPR-së të MPB-së ka ndarë me OSHC-të të dhënat e LHT-ve të kthyer dhe familjeve dhe të vendndodhjeve të komuniteteve pritëse. Për më tepër, OSHC-të u përfshinë në hartimin e programit të RdheR në Kosovë, të financuar nga IOM-i dhe të udhëhequr nga DPRPR-ja.<sup>68</sup>

Për ta ilustruar më tej, Fondi për Zhvillimin e Komunitetit (CDF), Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim, Community Building Mitrovica dhe disa OJQ të tjera lokale në koordinim me DPRPR-në e zbatojnë programin RdheR në Kosovë duke u bazuar në nevojat individuale të të kthyerve. Të kthyerve (grave) u ofrohen kurse profesionale dhe klasa prindërimi dhe mbështeten nëpërmjet ofrimit të granteve — si dhe krijimit të lidhjeve me bizneset lokale nëpërmjet ofrimit të punës praktike (stazhit).<sup>69</sup> E njëjta gjë vlen edhe për të kthyerit meshkuj. Edhe pse arrestohen pas kthimit të tyre, atyre u ofrohen kurse profesionale në burgje.

Për më tepër, ata organizojnë aktivitete teatrale ku fëmijët e shkollës i shikojnë shfaqjet dhe vazhdojnë të diskutojnë specifikat; aktivitete rekreative dhe edukative (vizitimi i vendeve historike dhe kulturore) si dhe shërimi dhe edukimi përmes arteve, terapisë së dramës dhe procesit të dramës, që u mundëson atyre të

<sup>67</sup> Mensur Hoti, Pyetësor për palët e interesuara të qeverisë, janar 2023

<sup>68</sup> Mensur Hoti.

<sup>69</sup> Rebeka Qena, Pyetësor për palët e interesuara nga OSHC-të, 28 shkurt 2023.

shprehin përvojat e tyre përmes arteve, gjë që u lejon atyre të përballen dhe të kapërcejnë traumat e tyre. Fëmijët e kthyer, si dhe prindërit e tyre nga ana tjetër, përfitojnë gjithashtu nga seancat individuale me psikiatrit, të cilët ofrohen përmes MPB-së në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë.<sup>70</sup>

GCERF themeloi një Mekanizëm Mbështetës Vendor (MMV) me shumë palë në Kosovë në vitin 2016, i cili është aktiv edhe sot. Mekanizmi kryesohet nga MPB-ja dhe përbëhet nga anëtarë nga institucione të ndryshme qeveritare, duke përfshirë anëtarë të komunitetit të donatorëve. Anëtarët e shoqërisë civile dhe të organizatave ndërkombëtare ofrojnë gjithashtu udhëzime strategjike për MMV-në. Funkzioni kryesor i MMV-së është të sigurojë pronësinë dhe mbikëqyrjen strategjike të punës së GCERF-it në Kosovë, nga vlerësimi i nevojave deri te zhvillimi i një strategjie për investime, zhvillimi i shprehjeve të interesit, shqyrtimi i aplikacioneve të propozimeve dhe rekomandime për financim.<sup>71</sup>

Kosova aktualisht është duke përgatitur nivelet lokale/komunale për të rritur kapacitetet e tyre në trajtimin e LHT-ve të rikthyer dhe CDF-ja është duke përgatitur një trajnim për trajnimin e trajnerëve, ku profile të ndryshme (psikiatër, psikologë, punonjës socialë) do të bëhen trajnerë të trajnerëve në adresimin e shëndetit mendor të të kthyerve dhe do të vazhdojë më tej me ofrimin e njohurive të tyre për profesionistët e nivelit lokal.

## Mësimet kryesore

1. Qeveritë dhe mekanizmat institucionalë në vetvete nuk mund të jenë të suksesshëm në P/KEDh pa një qasje me shumë agjenci dhe multidisiplinare, ku roli i OJQ-ve dhe i shoqërisë civile është vendimtar.
2. Mekanizmat e referimit me shumë agjenci dhe multidisiplinar kanë dhënë rezultate në P/KEDh, veçanërisht në modelet e disa vendeve të Ballkanit Perëndimor që aplikojnë një përfshirje aktive të subjekteve të ndryshme të shoqërisë civile.
3. Roli i organeve të zbatimit të ligjit është vendimtar në P/KEDh, veçanërisht duke marrë parasysh ekspertizën e tyre në parandalimin dhe luftimin e terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Megjithatë, bashkëpunimi ndërmjet organeve të zbatimit të ligjit dhe aktorëve të tjerë përkatës në disa vende të rajonit nuk është në nivel të kënaqshëm.
4. Programet e RdheR në BP funksionojnë/ekzistojnë dhe mund të jenë efikase në minimizimin e ekstremizmit të dhunshëm, veçanërisht me përfshirjen aktive të mekanizmave të pushtetit lokal. Janë qindra LHT dhe familjet e tyre që tashmë janë kthyer në BP. Deri më tani, nuk ka pasur dëshmi për ripërfshirje të tyre në rastet e terrorizmit (raste të recidivizmit).
5. Modele të ndryshme të mekanizmave të referimit që përdoren në vendet e BE-së mund të përdoren nga vendet e Ballkanit Perëndimor, duke u përshtatur sipas kontekstit lokal.

<sup>70</sup> Rebeka Qena.

<sup>71</sup> Mensur Hoti, Pyetësor për palët e interesuara të qeverisë.

## Rekomandime

1. Të sigurohet se nuk do të sekuritizohet procesi, përmes ofrimit të mundësive dhe caktimit të përgjegjësive tek aktorët e tjerë relevantë, duke përfshirë institucionet arsimore, punonjësit socialë, psikologët, psikiatrit, OSHC-të.
2. Të krijohet dhe të forcohet bashkëpunimi, duke përfshirë shkëmbimin e informacionit dhe ndërtimin e besimit të ndërsjellë midis organeve të zbatimit të ligjit dhe aktorëve të përmendur më sipër: institucionet arsimore, punonjësit socialë, psikologët, psikiatrit, shoqëria civile, duke përfshirë mediat.
3. Ekspertiza e policisë dhe e inteligjencës duhet të përdoret për vlerësimin e rrezikut të personave të radikalizuar, duke organizuar trajnime të përbashkëta me palët e tjera të interesit.
4. Policia, shërbimet e provës dhe shërbimet korrektuese duhet të rrisin shkëmbimin e informacionit për të dënuarit për ekstremizëm të dhunshëm dhe terrorizëm me palët e tjera të interesit të përfshira në zbatimin e aktiviteteve në RdheR mbi bazën e nevojës për të ditur dhe nevojës për të ndarë informacionin.
5. Nxitja për ngritjen e kapaciteteve në P/KEDh në nivel lokal (midis organeve të zbatimit të ligjit, punonjësve socialë, psikologëve, etj.), duke përfshirë zbatimin e programeve të RdheR.
6. Duhet të rritet bashkëpunimi midis aktorëve të tjerë dhe policisë jo vetëm në KEDh, por edhe në parandalim, pa e cenuar besimin në komunitet.
7. Mbrojtja e këtyre përpjekjeve duke krijuar mekanizma të qëndrueshëm nëpërmjet planifikimit financiar afatgjatë kombëtar dhe lokal.

## Materiale për lexim

1. Kiran M. Sarma. (2019). Multi-Agency Working and preventing violent extremism: Paper 2. [https://home-affairs.ec.europa.eu/system/files/2019-04/ran\\_hsc\\_policy\\_mawr\\_report\\_sarma\\_26032019\\_en.pdf](https://home-affairs.ec.europa.eu/system/files/2019-04/ran_hsc_policy_mawr_report_sarma_26032019_en.pdf)
2. United Kingdom Home Office (2021). Prevent Multi-Agency Panel Duty guidance: protecting people vulnerable to being drawn into terrorism. Statutory guidance for panel members and partners of local panels. <https://www.gov.uk/government/publications/channel-and-prevent-multi-agency-panel-pmap-guidance#:~:text=Details,while%20PMAP%20operates%20in%20Scotland.>
3. Radicalisation Awareness Network (2017). EX POST PAPER The role for police officers in multi-agency working and information sharing. [https://home-affairs.ec.europa.eu/system/files/2020-09/ran\\_pol\\_role\\_for\\_police\\_officers\\_utrecht\\_212016\\_en.pdf](https://home-affairs.ec.europa.eu/system/files/2020-09/ran_pol_role_for_police_officers_utrecht_212016_en.pdf)
4. Radicalisation Awareness Network (2019). Ex Post Paper What role do police play in the resocialisation and risk management of released former terrorist offenders? [https://home-affairs.ec.europa.eu/system/files/2019-06/ran\\_pol\\_role\\_do\\_police\\_play\\_in\\_resocialisation\\_marseille\\_20190520\\_en.pdf](https://home-affairs.ec.europa.eu/system/files/2019-06/ran_pol_role_do_police_play_in_resocialisation_marseille_20190520_en.pdf)
5. Radicalisation Awareness Network (2018). RAN ISSUE PAPER Multi-agency working and preventing violent extremism I. [https://home-affairs.ec.europa.eu/system/files/en?file=2020-09/multi-agency-working-preventing-violent-extremism-042018\\_en.pdf](https://home-affairs.ec.europa.eu/system/files/en?file=2020-09/multi-agency-working-preventing-violent-extremism-042018_en.pdf)
6. Organization for Security and Co-operation in Europe (2019). Understanding Referral Mechanisms in Preventing and Countering Violent Extremism and Radicalization That Lead to Terrorism Navigating Challenges and Protecting Human Rights A Guidebook for South-Eastern Europe. <https://www.osce.org/files/f/documents/7/4/418274.pdf>

### Për autorin:

**Fatos Makolli** ka gradën Master i arteve në studimet strategjike të sigurisë dhe kundër terrorizmit në Kolegjin për Çështjet e Sigurisë Ndërkombëtare, në Universitetin Kombëtar të Mbrojtjes. Ai gjithashtu përfundoi një program të nivelit të lartë të studimeve në strategjinë e sigurisë dhe luftën e parregullt në Kolegjin e Luftës, Uashington DC. Përveç kësaj, ai gjithashtu u diplomua nga Sesioni i Akademisë Kombëtare të FBI-së 262 në FBINA Quantico, VA. Fatosi ka 14 vjet përvojë në LT/KEDh si Drejtor i Kundër Terrorizmit në Kosovë dhe ka qenë anëtar i disa grupeve punuese ndërqeveritare për hartimin e ligjeve dhe gjithashtu për hartimin dhe zbatimin e strategjive të ndryshme të sigurisë kombëtare duke përfshirë Strategjinë Kundër Terrorizmit dhe Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit.



## Bibliografia

- 'A Whole-of-Society Approach to Preventing and Countering Violent Extremism and Radicalization That Lead to Terrorism'. Accessed 3 February 2023. [https://www.osce.org/files/f/documents/a/7/444340\\_0.pdf](https://www.osce.org/files/f/documents/a/7/444340_0.pdf)
- 'Aarhus Model: Prevention of Radicalisation and Discrimination in Aarhus'. Accessed 16 October 2022. [https://home-affairs.ec.europa.eu/networks/radicalisation-awareness-network-ran/collection-inspiring-practices/ran-practices/aarhus-model-prevention-radicalisation-and-discrimination-aarhus\\_en](https://home-affairs.ec.europa.eu/networks/radicalisation-awareness-network-ran/collection-inspiring-practices/ran-practices/aarhus-model-prevention-radicalisation-and-discrimination-aarhus_en)
- Afrodita Musliu. CSO stakeholder questionnaire, n.d.
- Ardit Orana and Skender Perteshi. 'Disengagement, Rehabilitation and Reintegration of Foreign Terrorist Fighters'. Accessed 12 August 2022. <https://qkss.org/en/publikimet/disengagement-rehabilitation-reintegration-foreign-terrorist-fiighters>
- Azinovic, Dr Vlado. Expert stakeholder questionnaire, 1 August 2022.
- 'Balkans-Regional-Report.Pdf'. Accessed 31 October 2022. <https://h2020connekt.eu/wp-content/uploads/2021/04/Balkans-Regional-Report.pdf>
- 'Channel Duty Guidance: Protecting People Vulnerable to Being Drawn into Terrorism', 56. Accessed 24 August 2022. [https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment\\_data/file/964567/6.6271\\_HO\\_HMG\\_Channel\\_Duty\\_Guidance\\_v14\\_Web.pdf](https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/964567/6.6271_HO_HMG_Channel_Duty_Guidance_v14_Web.pdf)
- Directorate-General for Neighbourhood and Enlargement Negotiations. 'Albania Report 2021'. Accessed 12 August 2022. [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2021\\_en](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2021_en)
- Directorate-General for Neighbourhood and Enlargement Negotiations.. 'Bosnia and Herzegovina Report 2021'. Accessed 10 August 2022. [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/bosnia-and-herzegovina-report-2021\\_en](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/bosnia-and-herzegovina-report-2021_en)
- Directorate-General for Neighbourhood and Enlargement Negotiations.. 'Kosovo Report 2021', 19 November 2021. [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/kosovo-report-2021\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/kosovo-report-2021_en)
- Directorate-General for Neighbourhood and Enlargement Negotiations.. 'North Macedonia Report 2021'. Accessed 16 August 2022. [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/north-macedonia-report-2021\\_en](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/north-macedonia-report-2021_en)
- DRIVE. 'The Project - MARTE - Methodology, Objectives, Expected Results'. Accessed 9 March 2023. <https://drive-ontherightpath.eu/the-project/>
- European Commission - European Commission. '2021 Enlargement Package'. Text. Accessed 31 October 2022. [https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip\\_21\\_5275](https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip_21_5275)
- European Commission - European Commission. '2022 Enlargement Package'. Text. Accessed 31 July 2023. [https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip\\_22\\_6082](https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip_22_6082)
- Fetiu, Arber, and Diana Mishkova. '31.12.2020 Diana Mishkova, Simeon Evstatiev', n.d., 22. <https://www.prevex-balkan-mena.eu/wp-content/uploads/2021/01/D5.1-Policy-brief-the-Balkans-1.pdf>
- GCERF. 'North Macedonia', 5 January 2022. <https://www.gcerf.org/north-macedonia/>
- 'GCERF-Strategy-for-Investment-in-the-Western-Balkans.Pdf'. Accessed 3 February 2023. <https://www.gcerf.org/wp-content/uploads/2015/12/GCERF-Strategy-for-Investment-in-the-Western-Balkans.pdf>
- Hoti, Mensur. Government stakeholder questionnaire, 30 July 2022.
- Hoti, Mensur. Government stakeholder questionnaire, 4 August 2023.
- Kapidži, Damir. 'BOSNIA AND HERZEGOVINA', 20. Accessed 12 August 2022. [https://h2020connekt.eu/wp-content/uploads/2021/01/Bosnia\\_CONNEKT\\_Approaches\\_to\\_extremism.pdf](https://h2020connekt.eu/wp-content/uploads/2021/01/Bosnia_CONNEKT_Approaches_to_extremism.pdf)
- Keka, Luan. Government stakeholder questionnaire, 21 June 2022.
- Lulzim Peci and Agon. 'Kosovo - Macro-Drivers of Radicalisation and Violent Extremism'. *Connekt* (blog). Accessed 4 August 2022. <https://h2020connekt.eu/publications/mapping-the-drivers-of-radicalisation-in-the-light-of-state-dynamics-in-kosovo/>
- Mensur Hoti. Government stakeholder questionnaire, January 2023.
- 'NSCITF-Report-on-Countering-Violent-Extremism.Pdf', n.d.

- 'Passage4Prevent-Prelom-Ang.Pdf'. Accessed 16 August 2022. <http://www.crpm.org.mk/wp-content/uploads/2019/07/Passage4Prevent-prelom-ang.pdf>
- Qena, Rebeka. CSO stakeholder questionnaire, 28 July 2022.
- Rebeka Qena. CSO stakeholder questionnaire, 28 February 2023.
- 'Referalni-Mehanizam-Za-Preveciju-i-Suzbijanje-Ekstremizma-i-Radikalizma.Pdf'. Accessed 1 November 2022. <https://www.kcdamad.org/wp-content/uploads/2019/09/Referalni-mehanizam-za-preveciju-i-suzbijanje-ekstremizma-i-radikalizma.pdf>
- Rosand, Eric, and Eric Manton. 'Lessons Learned from Preventing and Countering Violent Extremism in the Western Balkans' 41 (2021): 4. [https://www.gcerf.org/wp-content/uploads/2021/05/rosand\\_and\\_manton\\_newsbrief.pdf](https://www.gcerf.org/wp-content/uploads/2021/05/rosand_and_manton_newsbrief.pdf)
- 'Serbia Report 2022'. Accessed 31 July 2023. [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/serbia-report-2022\\_en](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/serbia-report-2022_en)
- 'Strategic Documents of MIAPA'. Accessed 1 August 2023. <https://mpb.rks-gov.net/f/39/Strategic-documents>
- 'The Role of Civil Society in Preventing and Countering Violent Extremism and Radicalization That Lead to Terrorism: A Guidebook for South-Eastern Europe'. Accessed 7 March 2023. <https://www.osce.org/secretariat/400241>
- 'Understanding Referral Mechanisms in Preventing and Countering Violent Extremism and Radicalization That Lead to Terrorism'. Accessed 7 March 2023. <https://www.osce.org/files/f/documents/7/4/418274.pdf>
- 'Understanding Referral Mechanisms in Preventing and Countering Violent Extremism and Radicalization That Lead to Terrorism: Guidebook for South-Eastern Europe'. Accessed 15 August 2022. <https://www.osce.org/secretariat/418274>
- United States Department of State. 'North Macedonia'. Accessed 16 August 2022. <https://www.state.gov/reports/country-reports-on-terrorism-2020/north-macedonia/>
- 'Uspon desnice: slučaj Srbija – Ekstremizam, terorizam, strani borci'. *helsinki odbor za ljudska prava u srbiji*, 2022, 284. <https://www.helsinki.org.rs/serbian/doc/Uspon%20desnice%20-%20slucaj%20Srbija.pdf>

## **GJETJA E INFORMACIONIT RRETH BE-së**

### **Online**

Të dhëna lidhur me Bashkimin Evropian në të gjitha gjuhët zyrtare të BE-së ka në ueb-faqen e Evropës në: [https://europa.eu/european-union/index\\_en](https://europa.eu/european-union/index_en)

### **Publikimet e BE-së**

Mund të shkarkoni ose të porositni publikime të BE-së falas dhe me pagesë nga: <https://op.europa.eu/en/publications>. Shumë kopje të publikimeve falas mund të gjenden duke kontaktur Europe Direct ose qendrën tuaj lokale të informimit (shih [https://europa.eu/european-union/contact\\_en](https://europa.eu/european-union/contact_en)).

### **Ligjet e BE-së dhe dokumentet përkatëse**

Për qasje në të dhëna ligjore nga BE-ja, duke përfshirë të gjitha ligjet e BE-së që nga viti 1952 në të gjitha versionet në gjuhët zyrtare, shkoni në EUR-Lex në: <http://eur-lex.europa.eu>

### **Të dhëna të hapura nga BE-ja**

Portali i të dhënave të hapura të BE-së (<http://data.europa.eu/euodp/en>) siguron qasje në grupet e të dhënave nga BE-ja. Të dhënat mund të shkarkohen dhe ripërdoren falas, për qëllime komerciale dhe jokomerciale.

Radicalisation Awareness Network

# RANI

## Practitioners



Publications Office  
of the European Union